

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 1

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 E martë, 3 tetor 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

4 --- Seanca fillon në orën 09.38

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëmëngjes. Dhe mirë se erdhët.

7 Sekretare e Gjykatës, paraqisni lëndën.

8 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
9 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-04, Prokurori i
10 Specializuar kundër Pjetër Shalës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit.

13 Nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, a mund të më
14 konfirmoni se jeni të njëjtët pjesëmarrës sikurse dje?

15 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Jemi të njëjtët pjesëmarrës.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 Mbrojtësi i Viktimave?

18 Z. LAWS: [Përkthim] Po, jemi të njëjtët persona.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Mbrojtja, a mund të na thotë kush është i pranishëm ose
21 të paktën na konfirmoni që jeni të njëjtët?

22 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jemi pothuajse njësoj. Është z.

23 Pjetër Shala që na ndjek me videolidhje. Jam unë, Jean-Louis

24 Gilissen. Jemi me znj. Leto Cariolou, Dzeneta Petravica, Judit

25 Kolbe edhe kemi dhe një stazhiere Deborah Thienaut, që është

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 2

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 me ne sot.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
3 Shala, na konfirmoni që po e dëgjoni përkthimin?

4 I AKUZUARI:[Përmes videolidhjes] Po, ju ndëgjoj mirë.
5 Faleminderit.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
7 mirë. Sot do të dëgjojmë dëshmitarin e tretë të Mbrojtjes, që
8 është z. Naser Koçinaj. Z. Koçinaj do të japë dëshmi pa masa
9 mbrojtëse në sallën e gjyqit. Do kemi tre seancat e rregullta
10 nga një orë e gjysëm secila dhe pushimet si zakonisht.

11 Asistente, ju lutem sillni dëshmitarin në sallën e
12 gjyqit.

13 [Trupi Gjygues dhe Sekretarja e Gjykatës
14 këshillohen]

15 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Uluni. Uluni, ju lutem, z. Koçinaj.

18 DËSHMITARI: Faleminderit.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Mirëmëngjes, z. Koçinaj. Dhe mirë se erdhët para Dhomave të
21 Specializuara të Kosovës.

22 DËSHMITARI: Mirëmëngjes.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A më
24 dëgjon mirë?

25 DËSHMITARI: Po.

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
2 Shala, ju e dëgjoni mirë dëshmitarin? Mund të kesh mikrofonin
3 e fikur, z. Shala? Mund të kesh mikrofonin e fikur.

4 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, ju ndëgjoj mirë.
5 Faleminderit.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Faleminderit. Tani mund ta fikni sërish mikrofonin.
8 Faleminderit.

9 Z. Koçinaj, si jeni?

10 DËSHMITARI: Mirë. Faleminderit.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sot
12 do fillojmë me dëshminë tuaj, por përpara se të fillojmë ka
13 disa udhëzime që dua t'ju jap.

14 Jeni këtu, pra, ju kanë thirrur për të dëshmuar në
15 çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër z. Shala të
16 ndihmsh Trupin Gjykes për të dalë me një vendim. Fillimisht
17 duhet të lexoni deklaratën solemne, betimin solemn, do t'ju
18 japim edhe disa udhëzime të tjera, disa instruksione.

19 Keni ardhur në këtë Gjykatë, jeni përpara Trupit Gjykes
20 këtu janë Mbrojtësi i Viktimave, Prokuroria dhe Mbrojtja.
21 Fillimisht pyetjet do jua bëj Mbrojtja, që janë në të djathtën
22 tuaj është ekipi i Mbrojtjes.

23 DËSHMITARI: Faleminderit.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
25 shoh që po pohoni me kokë. Nga ana tjetër janë përfaqësuesit

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 4

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 nga Zyra e Prokurorit të Specializuar që po ashtu kanë pyetje
2 për ju.

3 DËSHMITARI: Faleminderit.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
5 më pas Mbrojtësi i Viktimave. Dhe ne, po ashtu, Trupi Gjykses,
6 mund të kemi pyetje në fund. E kuptoni këtë?

7 DËSHMITARI: Po. Faleminderit. Po.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
9 mirë. Sikurse ju thashë para se të bëni betimin solemn, do ju
10 jap disa udhëzime praktike, ndaj më dëgjoni me kujdes.

11 Do t'ju drejtojnë pyetje. Por, nëse nuk e kuptoni një
12 pyetje, lirisht kërkoni që pyetja të përsëritet. Në rregull?

13 DËSHMITARI: Po.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ne
15 duam të thoni të vërtetën, të na thoni çfarë keni parë me sytë
16 tuaj, çfarë keni përjetuar, çfarë keni ndjerë, çfarë keni
17 dëgjuar. Në qoftë se diçka nuk e keni parë me sytë tuaj apo
18 nuk e keni dëgjuar vetë, na thoni nga e keni mësuar këtë
19 informacion.

20 Mbase nuk do ju kujtohet të gjitha hollësitë e ngjarjeve,
21 prandaj lirisht mund të thoni "nuk e di" ose "nuk më
22 kujtohet". Mirë?

23 DËSHMITARI: Po.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mos
25 hamendësoni, mos sajoni informacione, mos trilloni

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 informacione. Është e qartë kjo?

2 DËSHMITARI: Po.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
4 lutem përgjigju vetëm pyetjes që ju drejtojnë. Pra, mos jepni
5 informacione shtesë. Nëse ne kemi nevojë për sqarime, ju bëjmë
6 ne pyetje shtesë, sepse kështu do marrim një dëshmi tamam në
7 thelb siç na duhet.

8 Ju kujtoj se keni të drejtën të kundërshtoni që të jepni
9 dëshmi për aspekte që mund t'ju vetëinkriminojnë, në bazë të
10 rregullës 151(1) të Rregullores.

11 E kuptoni këtë?

12 DËSHMITARI: Po.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Gjithashtu dua t'ju them disa gjëra të tjera lidhur me
15 dëshminë tuaj, çdo gjë që themi këtu përkthehet dhe
16 regjistrohet. Që do të thotë që është e rëndësishme të flisni
17 para mikrofonave që keni përpara, të flisni qartë, mos pohoni
18 me kokë sepse në qoftë se nuk thuhet me zë diçka nuk
19 regjistrohet dot, pra, flisni me zë dhe flisni ngadalë.

20 DËSHMITARI: Okej.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë?

22 Gjithashtu një udhëzim tjetër që dua t'ju jap është sinë
23 vijim, kur t'ju bëjnë një pyetje, prisni pesë sekonda përpara
24 se të përgjigjeni, sepse ky pesë sekondëshi është i
25 rëndësishëm për përkthim dhe për regjistrim, i jep mundësi, i

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 jep kohën e nevojshme që të përfundojë fjalë në përkthim
2 përpara se të filloni ju të përgjigjeni. Sepse nuk duhet që të
3 kemi folës që flasin njëherazi.

4 Nëse unë ngre dorën siç bëra tani, ndaloni së foluri.
5 Ndonjëherë mund të ndodhë që t'ju kërkojmë të dilni nga salla
6 e gjyqit, këtë e bëjmë kur duhet të diskutojmë pyetjet që ju
7 janë drejtuar dhe nuk duhet t'i dëgjoni ju që të mos
8 influencoheni nga diskutimi që do bëhet brenda në sallën e
9 gjyqit.

10 Nëse ju keni ndonjë pyetje, keni nevojë për pushim apo
11 doni të ndani diçka me Trupin Gjykses, ngrini dorën dhe unë do
12 t'ju jap fjalën.

13 DËSHMITARI: Okej.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe,
15 në fund, mbase mund t'ju kërkohet të bëni ndonjë shënim në
16 monitorin që ke përpara, Asistentja do ju ndihmojë, do ju jap
17 një stilolaps, një marker që të bëni shënimet përkatëse nëse
18 lind nevoja. A janë të qarta këto?

19 DËSHMITARI: Po.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
21 rregull. Z. Koçinaj, si me çdo dëshmitar tjetër në këtë sallë
22 gjyqi do ju lutem të bëni betimin solemn dhe ju kujtoj se
23 është veprë penale në juridiksionin e Dhomave të Specializuara
24 të jepni dëshmi të rremë. E kuptoni këtë?

25 DËSHMITARI: Po, e kuptoj.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 7

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Asistente, ndihmojeni dëshmitarin me tekstin.

3 DËSHMITARI: Betimi solemn sipas Rregullores 141(2). I

4 ndërgjegjshëm/e ndërgjegjshme për rëndësinë e dëshmisë sime

5 dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të

6 them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe

7 nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

8 DËSHMITARI: NASER KOÇINAJ

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Faleminderit, z. Dëshmitar.

11 Tani mund të fillojmë me pyetjet nga ekipi i Mbrojtjes.

12 Avokat, keni kërkuar tre orë për pyetjet tuaja. Ka ndonjë

13 ndryshim? Nëse ka ndryshim, ju lutem na njoftoni.

14 Dhe diçka nga pikëpamja e organizimit, shoh që z. Aouini

15 është po ashtu në sallën e gjyqit, kjo është për procesverbal.

16 Avokat, fjala është për ju.

17 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

18 Pyetje nga z. Gilissen:

19 Z. GILISSEN: [Përkthim]

20 PY. Mirëmëngjes, z. Dëshmitar.

21 PË. Mirëmëngjes.

22 PY. Unë jam z. Gilissen, jam Avokati Mbrojtës i z. Shala. Unë

23 kam disa pyetje për ju. Ju lutem përgjigjuni vetëm pyetjes që

24 do t'ju drejtoj. Nëse kam nevojë për sqarime do ju bëj unë

25 pyetje të mëtejshme.

1 PË. Në rregull.

2 PY. Faleminderit. Z. Dëshmitar, a mund të na thoni emrin dhe
3 mbiemrin?

4 PË. Naser Koçinaj.

5 PY. A ke nofkë apo a ke pasur ndonjëherë ndonjë nofkë?

6 PË. Jo.

7 PY. Shumë e qartë. Faleminderit. A mund të na thuash datën e
8 lindjes dhe vendin e lindjes?

9 PË. Më 2 dhjetor 1970, Vermicë, komuna e Prizrenit.

10 PY. Faleminderit. Ku jetonit përpara se të fillonte lufta në
11 1998?

12 PË. Në Prizren.

13 PY. Doja të më thoni a keni qenë i kyçur në UÇK?

14 PË. Po.

15 PY. A mund të na shpjegoni se në ç'kushte, në ç'rrethana u
16 kyçët ju në UÇK, si ndodhi që u kyçët në UÇK?

17 PË. U kyçëm se u mobilizue gjithë Kosova dhe mandej u kyçëm
18 edhe na në UÇK.

19 PY. A mund të na thoni kur, pra, kur?

20 PË. Ka qenë, nuk më kujtohet kështu me datë po viti 1998 ka
21 qenë. Data saktë nuk muj me i mbajt mend. 1998 ka qenë që kam
22 shku në Shqipëri për herë të parë.

23 PY. Në rregull. Si shkove në Shqipëri?

24 PË. Kam shkue nëpër mal, bjeshkës.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Avokat, më lejoni një çast. Z. Dëshmitar, tha që u kyç në UÇK
2 në vitin 1998, po a mund të keni diçka më specifike për vitin
3 1998.

4 Z. GILISSEN: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar].

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të
6 paktën ta ndajmë me stina se 1998 është shumë e përgjithshme.

7 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, po do ta pyes dhe për këtë.
8 PY. Dëshmitar, si u kyçët në UÇK, pra, në ç'rrethana, në
9 ç'kushte?

10 PË. Unë në 1998 kam shku në Shqipëri për herë të parë. Prej
11 1998, domethënë, jam i kyçur në UÇK.

12 PY. Faleminderit. Në cilin vend të Shqipërisë keni qenë?

13 PË. Në Kukës. Po.

14 PY. A e kam kuptuar siç duhet që ju jeni kyçur në UÇK në
15 Kukës, kështu?

16 PË. Po. Në 1998 për herë të parë kam shku në Shqipëri, kam
17 marrë armën dhe jam kthi në Kosovë.

18 PY. Shumë mirë. A mund të na tregoni diçka më shumë për këtë,
19 si ndodhi kjo? Ku në Kukës? Se Kukësi është qytet i madh,
20 është qytet. A mund të na thuash diçka më konkrete? Si ndodhi?

21 PË. Ne kena shku në mënyrë të organizume prej Prizrenit. U
22 thashë që kam pasë babën, kemi shku në Kukës. Kemi marrë armët
23 edhe jemi kthi për Kosovë, deri, domethënë, derisa kemi ndejt
24 në Kosovë derisa na kanë qitë serbët prej Kosovës për
25 Shqipëri.

1 PY. Pra, a keni qenë pjesë e ndonjë grupi konkret, brigade a
2 njësiti a kishte ndonjë emër?

3 PË. Jo. S'ka pasë emër hiç. Ne jena kanë me babën. Domethënë
4 baba ka qenë organizator. Na ka çu në Shqipëri. Na ka pru.
5 S'ka pasë emën grupi. Kush ka dash vetë ka ardhë.

6 PY. Pra, ju na thatë që ju përzunë nga Kosova.

7 PË. Po.

8 PY. Në momentin që u përzunë nga Kosova ku shkuat ju?

9 PË. Në Kukës.

10 PY. Në këtë momente u kyçët në UÇK, në këtë çast?

11 PË. Jo, kur na kanë përzru, domethënë, poshtë kur kemi shku në
12 mobilizim jam kyç mandaj prapë në UÇK. Mobilizimi i
13 përgjithshëm ku ka qenë i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovë, jam
14 kyç në UÇK.

15 PY. Faleminderit. E qartë. Në Kukës ku qëndronit ju, ku ishit
16 të vendosur?

17 PË. Unë në Kukës kam punu te, ka jam qëndru te magazina numër
18 2. Për herë të parë aty kam shku edhe kam punu në magazinë ku
19 jipen uniformat, ku kanë ardhë ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare
20 të Kosovës me u veshë. Unë ia kam dhënë uniformat. Aty edhe
21 ata kanë pasë drejtimin e vetë ka kanë shku. Qatë punë e kam
22 pasë unë.

23 PY. A jeni të gjendje të na thoni, nga sa kohë e mbajtet këtë
24 detyrë, nga cila periudhë, pra, deri në cilën periudhë?

25 PË. Mobilizimi i përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të

1 Kosovës kur ka qenë deri në fund.

2 PY. Në rregull. Ky mobilizimi i përgjithshëm kur filloi, ju
3 kujtohet data, kur nisi?

4 PË. Jo, s'më kujtohet data. Kur kanë ardhë të gjithë që na
5 kanë përzënë shkijat te poshtë qëta jena mobilizu gjithë krejt
6 Kosova. S'më kujtohet data saktë.

7 PY. Ka qenë para apo pas bombardimit të NATO-s?

8 PË. Jo, para. Në bombardim, taman pi kur ka bombardu NATO që
9 kemi ik për Shqipërie, q'atë herë.

10 PY. Faleminderit. Ju thatë "deri në fund". A je në gjendje të
11 na thuash ose datën ose të paktën periudhën, çfarë konsideroni
12 ju "deri në fund" cila periudhë kohore është kjo?

13 PË. Deri sa ka hi KFOR-i, NATO.

14 PY. A mund të themi, që ju ishit në Kukës në fabrikën e
15 metalit deri nga mesi i majit 1999 deri në fillimin ose deri
16 më saktë deri në 1 qershor të 1999 a mund të themi që kjo
17 është periudha?

18 PË. Unë me data nuk e di, vetëm e di kur ka hi KFOR-i, me
19 q'atë date janë hi në Kosovë me gjithë KFOR. Nuk e di sa ka
20 qenë data. S'më kujtohen datat. Bashkë me KFOR-in gjerman jam
21 hi në Kosovë.

22 PY. Që ta kuptojmë. Pas luftës, kështu, deri në fund të
23 luftës?

24 PË. Deri në fund të luftës

25 PY. Faleminderit.

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] Është ë e qartë besoj tani.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
3 përmendët disa data, është e qartë që dëshmitari s'po
4 konfirmon data, po megjithatë është në gjendje, ai thjesht
5 përsëriti ato që thatë ju në lidhje me datat.

6 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mendoj se kjo mjafton.
7 Faleminderit.

8 PY. Çfarë roli kishit ju në UÇK?

9 PË. Unë kam qenë në logjistikë. Në magazinë ku jipen
10 uniformat e UÇK-së. Q'aty kam punu deri në fund të luftës.

11 PY. Gjatë muajit që keni qenë në fabrikën e metalit në Kukës,
12 ku flinit ju?

13 PË. Unë e kam pasë shtëpinë teme në Kukës te lagja numër 3
14 kam banu me familjen me krejt. Me familjen time ka banu te
15 lagja 3, në Kukës.

16 PY. Po në fabrikën e metalit në Kukës a fjetët ndonjëherë?

17 PË. Jo, nuk ka pasë kushte për me fjet aty ku kam punu unë.
18 Aty ka pasë veç uniforma, nuk ka pasë asnjë gjë tjetër.

19 PY. A mund të na përshkruani planimetrinë e ndërtesës si
20 ishte, me fjalë të thjeshta, planimetria e fabrikës së metalit
21 në Kukës.

22 PË. S'e kuptova mirë pyetjen.

23 PY. Thjesht na përshkruani ndërtesën, ndërtesat, thjesht na
24 përshkruani si ishin këto ndërtesat në fabrikën e metalin në
25 Kukës, si ishte vendi i organizuar aty dhe pastaj unë do t'ju

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 13

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 tregoj një fotografi nga ajri dhe nga toka të fabrikës së
2 metalit në Kukës. Në rregull?

3 PË. Q'aty ku kam qenë te uniformat, aty s'ka qenë, s'ka pasë
4 asnjë gjë, asnjë send s'ka pasë, as banim. S'ka mujt me banu
5 aty, s'ka pasë banim, ku kam qenë unë, ku kam punu unë.

6 PY. A mund të na shpjegoni ku ishte e vendosur magazina në
7 fabrikën e metalit në Kukës? Në ç'vend të fabrikës së metalit
8 ishte magazina? Pra, kur hynë te ky kompleks ndërtesash,
9 magazina ku ishte?

10 PË. Kur kena hi, domethënë, në derë ka qenë në ballë atje.
11 Domethënë, prej derës drejt e në ballë te magazina ku kam punu
12 unë aty. Ballë për ballë ka qenë me derën e hymjes.

13 PY. Faleminderit.

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] Znj. Sekretare, unë desha t'i
15 tregoj disa fotografi dëshmitarit të fabrikës së metalit. Së
16 pari --

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
18 fillim do ta nxjerrim pak dëshmitarin sepse duhet të diskutoj
19 diçka me ju.

20 Z. Dëshmitar, Asistentja do t'ju nxjerri nga salla, ne do
21 të diskutojmë diçka ligjore. Faleminderit.

22 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kam
24 një preferencë që herën tjetër, ashtu si dje, në fillim të
25 tregoni fotografinë dhe ta pyesni dëshmitarin nëse ai e njeh

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 14

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 atë fotografi. Sepse në qoftë se i thoni se çfarë do t'i
2 tregoni atëherë pesha e dëshmisë që do të japë dëshmitari
3 është më e vogël sesa ajo që do t'i jepet dëshmisë së
4 dëshmitarit nëse ai e thotë vetë.

5 Siç i thashë kolegut tuaj. Në fillim tregojini
6 fotografinë, pastaj nëse e njeh dhe thotë që "Është fabrika e
7 metalit", atëherë do të vazhdoni.

8 Znj. Sekretare, a mund ta thërrasim përsëri dëshmitarin?

9 [Dëshmitari vijon dëshminë]

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
11 se erdhët përsëri, z. Dëshmitar.

12 Atëhere ia jap fjalën përsëri Avokatit Mbrojtës,
13 Mbrojtësit.

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit shumë.

15 Pra, znj. Sekretare, a mund të na nxirrni një fotografi.
16 Është një foto ajrore e fabrikës së metalit në Kukës, ERN
17 SPOE00330362-00330362.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
19 Sekretare, ju lutem nxirrni fotografinë.

20 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, a mund të shohim pak pamjen.
21 PY. A e njihni këtë pamje, Dëshmitar?

22 PË. Po, e njoh.

23 PY. Në rregull. A jeni në gjendje të na thoni se ku është
24 magazina për të cilën po flasim?

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 15

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 Sekretare ose Asistente, ju lutem a mund t'i jepni një shënues
2 apo një laps dëshmitarit në mënyrë që të shënojë se ku është
3 magazina. Faleminderit.

4 DËSHMITARI: A muj me shënu?

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
6 ju lutem.

7 DËSHMITARI: Hymja kryesore, dera ka kam hy unë. A me
8 shkru? Okei? Hymja kryesore, dera qetu. Unë qetu kam punu.
9 Qetu kam qenë.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
11 lutem, vini numrin 1 tek hyrja dhe numrin 2 tek vendi ku keni
12 punu ju.

13 DËSHMITARI: [Shënon]

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
15 mund të vazhdoni. Kam një koment. Dëshmitari ka folur për
16 magazinën që është magazina 2. Dhe kështu e quajti ai. Dhe ju
17 lutem të vazhdojmë me gjuhën dhe formulimet që përdori
18 dëshmitari.

19 Z. GILISSEN: [Përkthim] Atëhere mund ta heqim fotografinë
20 nga ekрани.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Atëhere këtë fotografi do ta ruajmë dhe do t'i japim një numër
23 prove materiale për procesverbalin.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse,
25 shënimet që janë bërë nga Dëshmitari DW4-05 kanë numrin

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 16

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 REG0968.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit, znj. Sekretare.

4 z. Gilissen, keni fjalën.

5 Z. GILISSEN: [Përkthim] Atëhere dua t'i tregoj

6 dëshmitarit edhe një foto tjetër që është ERN SPOE40010264-

7 12010559, në faqen 2.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për

9 të njëjtin qëllim, apo jo?

10 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

12 lutem, znj. Sekretare, vendoseni fotografinë.

13 Z. GILISSEN: [Përkthim]

14 PY. Z. Dëshmitar, a e njihni këtë vend dhe a mund të na

15 shpjegoni se çfarë shikoni këtu?

16 PË. Që ky vend nuk po më kujtohet mu. Unë vetëm aty ku jua

17 bëna 1 dhe 2, vetëm atë vend e di. Veç këtë s'po di. S'po muj

18 me ditë qëta.

19 Z. GILISSEN: [Përkthim] Pra, atëherë duhet t'i vendosim

20 një numër edhe kësaj fotografie që i kemi treguar dëshmitarit.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju e

22 dhatë numrin ERN të kësaj prove. Dëshmitari tani tha që nuk e

23 njeh këtë vend. Kështu që jemi në rregull. I vetmi moment kur

24 i japim numër shtesë është kur i shtohet diçka fotografisë kur

25 bënë shënime dëshmitari. Faleminderit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 17

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] Atëhere fotografinë ERN
2 SPOE40010264-10010559. Më duket se kjo është e njëjta, i
3 njëjti numër prove materiale, po kjo të shohim faqen 15 dhe
4 16.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
6 qëllimin për këtë?

7 Z. GILISSEN: [Përkthim] Për të njëjtin qëllim, për të
8 parë nëse e njehë këtë vend apo jo.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
10 Sekretare, mund ta vendosni.

11 Z. GILISSEN: [Përkthim]

12 PY. Z. Dëshmitar, a e njihni këtë ndërtesë?

13 PË. S'po më kujtohet as që kjo.

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] Në rregull. Atëhere mund të
15 shohim edhe fotografinë tjetër në faqen 16.

16 PY. E njëjta pyetje, z. Dëshmitar. A e njihni këtë vend?

17 PË. Vetëm, domethënë, praktikisht vetëm derën po e shof aty
18 ka shku unë te magazina. Tjetër send nuk po di. Nuk më
19 kujtohet kjo. S'kam pasë punë unë në këto.

20 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ju lutem, a mund të shikojmë
21 faqen 12 të të njëjtit dokument.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Vetëm
23 një pyetje sqaruese desha.

24 Z. Dëshmitar, ju sapo thatë, në faqen 15, rreshti 23 i
25 procesverbalit, ju thatë që:

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 18

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 "Vetëm derën po e njof..."

2 Për cilën derën e keni fjalën? Dhe nëse mund ta shënoni
3 ju lutem.

4 DËSHMITARI: Derën në hymje kryesore. Po më duket qashtu
5 si dera kryesore, tash s'po muj me kuptu.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
7 rregull. Ju lutem shënojeni me numrin 3. Sa për të qenë të
8 qartë se çfarë keni dallu aty në atë fotografi.

9 DËSHMITARI: [Shënon]

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Faleminderit, z. Dëshmitar.

12 Atëhere kjo foto të ruhet ju lutem si provë materiale. Ju
13 deshët të vazhdoni me një foto tjetër?

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po. Desha të shohim fotografinë
15 në faqen 12.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
17 fillim të ruhet kjo fotografi dhe pastaj të kalojmë te faqja
18 12.

19 Znj. Sekretare, ju lutem t'i japim një numër.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Shënimet e bëra nga
21 Dëshmitari DW4-05 do t'i jepet numri ERN i provës materiale
22 REG00969.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Faleminderit, Sekretare.

25 Z. Gilissen, keni fjalën. Dhe do t'i kërkoj Sekretares të

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 19

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 na çojë në faqen 12, ju lutem.

2 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ndoshta është afruar shumë.

3 PY. Z. Dëshmitar, a e njihni këtë vend?

4 PË. Po më duket si te magazina ku kam punu unë. Qaty po më

5 duket. Qe kjo dera këtu si e prishme që kjo është.

6 PY. Faleminderit. A mund t'i jepet një numër kësaj

7 fotografie?

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Së

9 pari desha të sqaroj këtë përmendjen e derës.

10 "Më duket se ishte kjo magazina ku kam punuar", tha

11 dëshmitari, "nga kjo dera këtu".

12 Është në faqen 17, rreshtat 5 dhe 6. Z. Dëshmitar, për

13 cilën derë e keni fjalën këtu?

14 DËSHMITARI: Ndoshta që kjo dera se s'po qet, s'po

15 kuptohet.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A

17 mund ta shënoni, ju lutem?

18 DËSHMITARI: Si qe kjo.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sepse

20 nëse nuk e shënoni nuk e shikoj dot. Vërinë numrin 4, ju

21 lutem.

22 DËSHMITARI: [Shënon]

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për

24 momentin nuk po shoh asgjë aty të shënuar.

25 Z. GILISSEN: [Përkthim] Në të djathtë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 20

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Faleminderit, Dëshmitar.

3 Z. Gilissen, atëherë do t'i jepet një numër.

4 Znj. Sekretare, ju lutem jepini një numër kësaj prove.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Shënimet e bëra nga

6 Dëshmitari DW4-05 i jepet numri ERN REG00970.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Faleminderit.

9 Z. Gilissen, mund të vazhdoni.

10 Z. GILISSEN: [Përkthim]

11 PY. Ju lutem, Dëshmitar, ju na thatë që punonit në këtë

12 magazinë. Por çfarë detyrash bënit ju aty, çfarë roli kishit

13 aty?

14 PË. Unë e kam pasë rolin vetëm me ia dhënë uniformat kush ka

15 ardhë aty për me u vesh për në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës,

16 kur është kyç, unë ia kam dhënë veç uniformat aty.

17 PY. Po kush ishte personi përgjegjës për atë magazinë?

18 PË. Personi përgjegjës që kam pasë unë punë vetëm me atë ka

19 qenë --

20 PY. A mund të na e jepni emrin e personit?

21 PË. Kelmendi me mbiemër, po s'po më kujtohet emri si e ka

22 pasë. Ai që kam qenë -- që ka qenë përgjegjës kryesor për

23 magazinën.

24 PY. Në rregull. Faleminderit.

25 PË. Nëse më kujtohet emri ndërkohë ua tregoj. Rexhep Kelmendi

1 ka qenë.

2 PY. Faleminderit.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

4 Dëshmitar, ju lutem mos flisni në të njëjtën kohë kur flet

5 edhe Avokati sepse nëse flisni të dy në të njëjtën kohë nuk

6 marrim përkthim. Faleminderit.

7 Z. GILISSEN: [Përkthim]

8 PY. Nëse doni të më ndërprisni ngrini dorën edhe unë ndaloj.

9 Atëhere gjatë natës, a mbyllej, a kyçej kjo magazinë apo
10 ishe e hapur?

11 PË. Jo, ka qenë e mbyllme.

12 PY. Ishte e mbyllur çdo natë?

13 PË. Po, çdo natë ka qenë e mbyllme.

14 PY. Faleminderit shumë. Kush ishte personi që e mbyllte këtë
15 magazinë çdo ditë ose çdo natë?

16 PË. Unë e kam mbyll derën dhe kam shku në shtëpi.

17 PY. Dhe kush ishte personi që e hapte magazinën çdo ditë?

18 PË. Unë e kam hap në ora 8.00 për çdo ditë magazinën.

19 PY. Dhe nuk e bënte kush tjetër të njëjtën gjë ndonjëherë?

20 PË. Nuk e besoj. Nuk e besoj se kur unë e kam mbyllë

21 magazinën unë e kam pa uniformat sa kanë qenë, kur kam shku të

22 nesrit kanë qenë prapë q'ato uniformat aty, domethënë,

23 faktikisht nuk e ka hap kërrkush. Se kam qenë përgjegjës për

24 uniformat.

25 PY. Faleminderit. A kishit dijeni për ndokënd, ushtar apo

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë private)

Faqe 22

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 civil që ka kalu natën ose disa net aty në këtë magazinë?

2 PË. Jo, nuk ka pasë civil aty.

3 PY. Po ushtarë gjatë natës?

4 PË. Jo, nuk ka pasë ushtarë gjatë natës. S'ka pasë kushte aty

5 për me nejtë askush. Për me pasë pastë kushte kisha nejt unë

6 aty. S'ka pasë kushte aty. Ajo a kanë magazinë vetëm për

7 uniforma.

8 PY. Atëhere sipas jush, është e sigurtë, që asnjëherë pa

9 përjashtim, askush, domethënë, nuk ka fjet asnjëherë aty?

10 PË. Kurrë hiç.

11 PY. Faleminderit. E kam shumë të qartë.

12 Dua t'ju bëj disa pyetje për persona, për disa persona.

13 Dhe i pari është për Osman Kryeziun. A e keni njoft dikënd me

14 emrin Osman Kryeziu?

15 PË. Jo, nuk e njoh. Jo.

16 Z. GILISSEN: [Përkthim] A mund të hyjmë në seancë

17 private, ju lutem, e nderuar Gjykatëse?

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund

19 të hyjmë në seancë private, znj. Sekretare.

20 [Seancë private]

21 [Seancë private teksti i fshirë]

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë private)

Faqe 23

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22 [Seancë e hapur]

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kemi hyrë përsëri në

24 seancë publike, të nderuar Gjykatës.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund

1 të vazhdoni, z. Avokat.

2 Z. GILISSEN: [Përkthim]

3 PY. Desha të di, z. Dëshmitar, a keni qenë ju anëtar i

4 Brigadës 128?

5 PË. Po. Mbasi jena kthy në Kosovë, domethënë, faktikisht kur

6 kena bë listën jam regjistru te Brigada 128, veç aty kam qenë.

7 PY. Pra, mesa po kuptoj, ju konfirmoni ka pasë një listë të

8 kësaj brigade?

9 PË. Po, po, ka pasë.

10 PY. Faleminderit. Desha të di a e njihni dikënd me ermin

11 Zijadin Hoxha?

12 PË. Jo, nuk e njof Zajadin Hoxhën.

13 PY. A njihni dikë me ermin Bedri Dervishaj?

14 PË. Po.

15 PY. A ishte ai anëtar i të njëjtës brigadë si edhe ju.

16 PË. Po.

17 PY. A keni idenë çfarë roli ka pasur ai në këtë brigadë, ka

18 qenë ushtar i thjesht, oficer, komandant?

19 PË. Nuk e di unë atë, listën e ka, nuk e di unë çka ka qenë

20 ai. Unë thjesht kam punu në magazinë, nuk e di se çka i kanë

21 emru komandanta nëpër vija atje të frontit. Nuk e di.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

23 Gilissen, desha një sqarim për diçka që tha dëshmitari,

24 përpara sesa të vazhdojmë me një temë tjetër, ju lutem më

25 lejoni ta bëj këtë.

1 Z. Dëshmitar, në faqen 21 të procesverbalit, rreshti 19,
2 thatë që:

3 "Kur u kthjem në Kosovë... ne hartuam listën..."

4 Kur thoni "kur" u kthjem në Kosovë "kur", për çfarë kohe
5 e keni fjalën? Kur ka qenë?

6 DËSHMITARI: Jo, lista a hartu shumë vonë, ama ne në
7 Kosovë jemi kthy me KFOR-in, tregova.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,
9 e keni fjalën për në fund të luftës? Këtë po thoni?
10 PË. Unë kur jam hi në Kosovë, domethënë, jam hi me KFOR-in.
11 Lista a formu shumë vonë. Një kohë e gjatë ka qenë lista që u
12 formu mandej me ditë na ku ka qenë ai, ku ka qenë ky. Na s'e
13 kemi ditë. Unë s'e kam ditë për vete. Unë jo, s'kam pasë
14 njohuri për këtë punë.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Pyetja që ju bëra unë ishte kjo, ju thatë që: "...jeni kthy në
17 Kosovë me KFOR-in".

18 DËSHMITARI: Po.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
20 mund të na thoni një datë kur ka qenë? Kur?

21 DËSHMITARI: Data s'më kujtohet, por q'atë ditë kur ka hi
22 KFOR-i q'atë natë jam hi menjëherë, prej, domethënë, prej
23 Kukësit me KFOR jam shkue në Prizren.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] S'ka
25 nevojë me më dhënë datë, po a ju kujtohet muaji kur ka qenë?

1 DËSHMITARI: Vallaj jo s'më kujtohet. Kur ka hi KFOR-i
2 thashë, nuk më kujtohen data.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kur
4 thoni "hartuam një listë" kush ishin këta "ne hartuam një
5 listë", kush ishin këta persona?

6 DËSHMITARI: Që kanë bërë listën e veteranëve.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Qartë. Tani u sqaruar pak më shumë.

9 Avokat, faleminderit. Avokat, vazhdoni tani.

10 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit. Do ju përpiqem t'ju
11 ndihmojë të gjithëve sa u takon datave.

12 PY. A keni dëgjuar gjë ju për Marrëveshjen e Kumanovës?

13 PË. Jo.

14 PY. Në rregull. Gjatë qëndrimit tuaj në fabrikën e metalit në
15 Kukës, a keni takuar, a keni njohur një person me emrin Pjetër
16 Shala?

17 PË. Jo.

18 PY. Po ndonjë person që të mbante nofkën Ujku apo Uki apo të
19 ngjashme Uki a Ujku a diçka të tillë?

20 PË. Jo, jo, s'kam ndëgju.

21 PY. Me sa dini ju, nofka Ujku ose Uki, a ishte një nofkë që
22 përdorej gjerësisht në Kosovë dhe në Shqipëri në vitin 1999,
23 ishte e zakonshme si nofkë?

24 PË. Nuk e kam ndëgju.

25 PY. Nëse në brigadë ka pasur një person, pra, nëse Brigada

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 27

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 128 do të kishte një person me emrin Pjetër Shala apo te ky
2 grupi përpara se të merrte emrin Brigada 128, a mendoni ju se
3 do ta dinit këtë informacion --

4 PË. Po, muj me pasë --

5 PY. -- do ishit në gjendje ta njihnit këtë person në qoftë se
6 do të kishte qenë pjesë e kësaj brigade apo grupi?

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

8 Dëshmitar, ndaloni një çast.

9 Prokurore, fjala është për ju.

10 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Besoj se kjo pyetje është
11 spekulative, për sa i takon dëshmitarit, atij u bë pyetja nëse
12 do ta njihnte ai, do ta dinte nëse një person me emrin Pjetër
13 Shala do të kishte qenë në brigadë, besoj se dëshmitari tha
14 diçka në lidhje me brigadën.

15 Megjithatë unë mendoj që dëshmitari nuk është në gjendje
16 të na përgjigjet me konkretësi lidhur me këtë pyetje.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë
18 mendoj se mund t'i përgjigjet pyetjes. Unë do ta lejoj
19 pyetjen.

20 Avokat, fjala është për ju. Mendoj që është mirë ta
21 përsërisni edhe njëherë pyetjen ose e --

22 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, do ta përsëris pyetjen.

23 PY. A i njihnit ju personat që ishin pjesë e Brigadës 128
24 qoftë me emër a me fytyrë? Dhe, pra, pyetja ime është kjo, ju
25 personat anëtarët e kësaj brigade ose të këtij grupi i

1 njihnit?

2 PË. Jo, s'kena mujt me i njof të gjithë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pata
4 merak se mos nuk e kuptonte pyetjen dëshmitari, po, në fakt,
5 dëshmitari e ka kuptuar shumë qartë pyetjen.

6 Z. GILISSEN: [Përkthim] Edhe unë u përpoqa që t'i
7 përgjigjesha koleges që të shmangim ndonjë paqartësi.

8 PY. Dëshmitar, që të sigurohemi, magazina për të cilën flisni
9 ju, a ishte magazina brenda fabrikës së metalit të Kukësit?

10 PË. Po.

11 PY. Ju faleminderit. Dëshiroj të flasim për një funeral. A ju
12 kujtohet të jetë mbajtur një funeral në fabrikën e metalit në
13 Kukës, një varrim, pra, të jetë bërë një varrim në fabrikën e
14 metalit në Kukës gjatë luftës?

15 PË. Vetëm dëshmorë Silver Maçkaj që a varros aty në Kukës.

16 Qëta e mbaj mend. Tjetër sen s'di.

17 PY. Ju kujtohet kur është bërë ky varrimi? Nuk është nevoja
18 të na jepni datën, po të paktën një periudhë kohore? Për
19 shembull, në fillim të qëndrimit tuaj, në mes të qëndrimit
20 tuaj, në fund të qëndrimit tuaj, pra, kur është bërë ky
21 varrimi, nëse keni mundësi të na e thoni?

22 PË. Nuk e di kur u bë varrimi. Nuk më kujtohen datat. Vetëm e
23 di që prej Kukësit a varrosë, prej aty a dalë, ama prej me
24 çfarë date nuk e di.

25 PY. Po a e dini si vdiq ky person?

1 PË. Nuk e di.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Avokat, ju kërkoj ndjesë që ju ndërpres. Dua që të sqarojmë
4 transkriptin. Në faqen 25, në rreshtin 19, thatë: "Duam të
5 flasim për një varrim" dhe ka humbur diçka këtu emri mbase.

6 Z. GILISSEN: [Përkthim] Unë këtë pyetje do t'i bëja.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po e
8 them se ka bërë një shënim përkthyesi këtu dhe ka thënë:
9 Përkthyesi nuk e ka kuptuar emrin e personit, nuk e ka
10 dëgjuar. Dhe unë po përpiqem të kuptoj a u tha ndonjë emër?

11 Z. GILISSEN: [Përkthim] Do t'ia bëj dhe njëherë pyetjen
12 për t'u siguruar që e ka kuptuar mirë dëshmitari.

13 PY. A na thatë dhe emrin?

14 PË. Po.

15 PY. Na e thatë emrin e heroit, e këtij dëshmorit?

16 PË. Po, Avokat. Po.

17 PY. A mund të na e thoni ju lutem qartë emrin e këtij
18 dëshmori?

19 PË. Emri i dëshmorit është Silver Maçkaj.

20 PY. Faleminderit. Ju keni qenë i pranishëm në këtë funeral,
21 në këtë varrim?

22 PË. Po.

23 PY. Jeni në gjendje të na përshkruani çfarë ndodhi në këtë
24 momente? A kishte shumë njerëz?

25 PË. Ka pasë.

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 30

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 PY. A kishte pak? Çfarë ndodhi pra?

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mos
3 ia jepni ju përgjigjen dëshmitarit, Avokat.

4 DËSHMITARI: Unë nuk e di. Ka pasë në varrim normal sikur
5 që varrosen njerëzit, ka pasë në varrim.

6 Z. GILISSEN: [Përkthim]

7 PY. Sipas jush me përiferësi sa persona kanë qenë në varrim?

8 PË. S'më kujtohet. Nuk po muj ditë tash 24, 25 vjet kjo punë
9 nuk po më kujtohet vallaj. Ka pasë një numër, po edhe aq shumë
10 kështu.

11 PY. Faleminderit. Të flasim për një temë tjetër tani. A keni
12 dijeni për ndonjë ordinancë apo ndonjë doktor të ketë qenë i
13 pranishëm në fabrikën e metalit në Kukës?

14 PË. Në fabrikën aty ka qenë Iliri, Ilir Rakaj ka qenë si
15 doktor. Mirëpo unë nuk kam pasë punë se nuk kam qenë smut
16 asnjëherë. S'kam shku kurrë te mjeku aty. Po e di që Iliri a
17 kanë aty. Edhe tash është invalid i luftës.

18 PY. Nga e njihni ju këtë person?

19 PË. Ilirin e kam edhe katundar, është i Vermicës, po edhe
20 shok e kam. Jemi kanë një gjeneratë.

21 PY. Ju faleminderit. Pra, gjatë luftës ju keni qëndruar në
22 Kukës apo jeni larguar?

23 PË. Jo, jo, në Kukës kam qenë.

24 PY. Në fund të luftës, ku ishit ju, pra, ju personalisht ku
25 keni qenë në fund të luftës?

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 31

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 PË. Në Kukës.

2 PY. Pastaj --

3 PË. Pastaj kur --

4 PY. Vazhdoni.

5 PË. Pastaj kur ka hi KFOR-i, unë me KFOR-in kam hi në Kosovë.

6 PY. Ku shkuat kur, domethënë, kur hytë të Kosovë ku shkuat?

7 PË. Kam shku në shtëpi.

8 PY. Çfarë ndodhi kur shkuat në shtëpi?

9 PË. Kam shku në shtëpi dhe kam ndejt në shtëpi s'kam dalë.

10 S'kam shku kërrkund ma. Napër qytet po, por dikund tjetër jo
11 kështu. Vetëm në Prizren kam nejt.

12 PY. Shumë faleminderit.

13 Z. GILISSEN: [Përkthim] Kaq pyetje kishim ne. Besoj se i
14 kam marrë të gjitha përgjigjet që më nevojiteshin. Nuk kemi
15 asnjë për të shtuar.

16 PY. Ju faleminderit, z. Dëshmitar.

17 DËSHMITARI: Faleminderit juve.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

19 Faleminderit, Avokat.

20 Ora është 11.00 pa 20. Znj. Prokurore, unë propozoj ta
21 bëjmë tani pushimin gjysmë ore dhe më pas të vazhdojmë me
22 pyetjet nga ana juaj.

23 A është kjo e volitshme për Prokurorin?

24 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Po, në rregull është për ne.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 32

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 Dëshmitar, tani do bëjmë gjysmë ore pushim dhe më pas do
2 vazhdojmë me pyetjet nga ana e Zyrës së Prokurorit të
3 Specializuar.

4 DËSHMITARI: Faleminderit, Gjyqtare.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Shihemi për gjysmë ore.

7 DËSHMITARI: Faleminderit.

8 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ne
10 rregull. Bëjmë gjysmë ore pushim.

11 --- Pauza fillon në orën 10.43

12 --- Seanca rifillon në orën 11.13

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
14 se u kthyet.

15 Shoh që ekipet janë siç ishin përpara pushimit.

16 Prokuroria po pohon me kokë.

17 Mbrojtësi i Viktimave po ashtu.

18 E njëjta gjë edhe për ekipin e Mbrojtjes.

19 Vazhdojmë tani me pyetjet për dëshmitarin. Radhën e ka
20 Prokuroria e Specializuar.

21 Asistente, sillni brenda dëshmitarin.

22 Z. Shala, na dëgjoni mirë?

23 I AKUZUARI: [përmes videolidhjes] Po, faleminderit. Mirë
24 ju dëgjoj.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 [Dëshmitari vijon dëshminë]

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

4 Shala, a mund ta fikni mikrofonin, ju lutem? Faleminderit.

5 Z. Dëshmitar, mirë se u kthyet.

6 DËSHMITARI: Faleminderit.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do

8 vazhdojmë tani me dëshminë tuaj. Pyetjet do t'i bëjë Zyra e

9 Prokurorit të Specializuar. Megjithatë, përpara se të vijojmë

10 me pyetjet, do bëjmë -- do japim një urdhër me gojë sa i takon

11 kërkesës së ZPS-së lidhur me tre materiale të nxjerra së

12 fundmi. Kërkesa është bërë dje me email. Janë tre postime në

13 Facebook. Pra konkretisht më 2 tetor, 13.39. Materialet u

14 nxorën në të njëjtën ditë në orën 9.32 të paradites. Është

15 paketa e nxjerrjes së materialeve numër 16 [sipas përkthimit].

16 Janë shtuar tashmë në listën e prezantimit për dëshmitarët.

17 Nuk ka pasur kundërshtime as nga Mbrojtja nga Mbrojtësi i

18 Viktimave lidhur me përdorimin e këtyre materialeve. Ne e

19 miratojmë përdorimin e këtyre materialeve, janë të shkurtra,

20 nuk janë shumë në sasi, edhe u është dhënë kohë e mjaftueshme

21 edhe Mbrojtësit të Viktimave edhe Mbrojtjes që t'i analizojnë.

22 Po ashtu marrim parasysh kërkesën e ZPS-së për ndryshimin

23 e listës të materialeve dhe listës përkuese të materialeve për

24 pyetjen e dëshmitarit. Materialet, kërkesën e kemi marrë dje

25 me postë elektronike në orën 8.23 të paradites.

1 Ka kundërshtime?

2 Z. GILISSEN: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

3 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Atëherë, Trupi Gjygues miraton kërkesën. Besojmë se dhe

6 Mbrojtja dhe Mbrojtësi i Viktimave janë në dijeni të

7 përmbajtjes së këtyre materialeve për të cilën është bërë

8 kërkesa.

9 Tani e ka fjalën Zyra e Prokurorit të Specializuar. Znj.

10 Prokurore, fjala është për ju.

11 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit.

12 Pyetje të palës tjetër nga znj. Pergolo:

13 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

14 PY. Mirëmengjes z. Koçinaj. Unë quhem Gaia Pergolo, jam një

15 nga Prokuroret në Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Unë do

16 t'ju bëj disa pyetje sot.

17 Fillimisht kam disa pyetje me mënyrën -- desha të pyes si

18 u bëtë ju dëshmitar për Mbrojtjen? A ju kujtohet kur ju ka

19 kontaktuar për herë të parë ekipi i Mbrojtjes?

20 PË. Nuk më kujtohet. Nuk e di. Nuk më kujtohet data kështu të

21 saktë. Po janë kanë ndosend nja shtatë muaj ose tetë muaj, por

22 data e saktë nuk e di.

23 PY. Faleminderit. Faleminderit, z. Koçinaj. Si të kontaktuan

24 për herë të parë? Si ka ndodhur kontakti i parë?

25 PË. Në Prizren jemi takue për herë të parë. Kanë thirrë dhe

1 kam shkue, ju kam përgjigj.

2 PY. Sa herë jeni takuar qysh prej herës së parë në Prizren,
3 pra nga hera e parë e deri sot që jeni në sallën e gjyqit, sa
4 herë jeni takuar?

5 PË. Ndoshta tri herë.

6 PY. Përpara se të bënit takimin e parë, e kishit lexuar ju
7 aktakuzën publike kundër Pjetër Shalës? E kishit lexuar
8 aktakuzën, akuzat e ngritura?

9 PË. Jo, s'e kam lexu.

10 PY. Po gjatë takimit, a t'u shpjegua çfarë çështje gjyqësore
11 ishte kjo kundër Pjetër Shalës?

12 PË. Vetëm ça kam pa nëpërmes televizorit, mandej edhe
13 nëpërmes Avokatit që ma ka spjegue.

14 PY. A patët mundësi ta rishikonit informacionin që i dhatë
15 Mbrojtjes pasi u takuat me ata? Ta rishikonit dhe njëherë atë
16 informacionin që kishit dhënë?

17 PË. Nuk e -- nuk e kam pa.

18 PY. Faleminderit. Tani do t'ju bëj disa pyetje për
19 vendndodhjen tuaj gjatë periudhës që është në aktakuzën e
20 kësaj çështje gjyqësore. Që i përkon periudha 17 maj deri në 5
21 qershor 1999. Sot paradite ju na dhatë informacion si u kyçët
22 ju në UÇK dhe ku ndodheshit në atë kohë.

23 Por pyetja e parë që kam unë është kjo: Ju keni qëndruar
24 vazhdimisht në fabrikën e metalit në Kukës, që nga momenti i
25 mobilizimit e deri në fund të luftës?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë private)

Faqe 36

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 PË. Po.

2 PY. A jeni larguar ndonjëherë nga baza e UÇK-së në fabrikën e
3 metalit në Kukës në këtë periudhë?

4 PË. Vetëm kur kam pasë punë, kur kam dalë prej aty që të jem
5 largu. Jam shkue për nevoja të mia personale me shkue nëpër
6 qytet, jam largu.

7 PY. Z. Koçinaj, po në Burrel a keni qenë ndonjëherë?

8 PË. Nuk kam qenë në Burrel.

9 PY. A keni dijeni për një incident që ka ndodhur në Burrel në
10 fillim të majit 1999?

11 PË. Jo, nuk e di se s'kam qenë në Burrel.

12 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do kërkoja
13 të kalonim shkurtimisht në seancë private për të diskutuar një
14 aspekt që është i përfshirë në dokumentet që janë ende
15 konfidenciale në këtë çështje gjyqësore. Kam disa pyetje
16 sqaruese në lidhje me këtë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
18 rregull. Sekretare, ju lutem të kalojmë në seancë private.

19 [Seancë private]

20 [Seancë private teksti i fshirë]

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë private)

Faqe 37

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24 [Seancë e hapur]

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 38

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

- 1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
- 2 Faleminderit.
- 3 Znj. Prokurore, mund të vazhdoni.
- 4 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]
- 5 PY. Po në Krumë, a keni qenë ndonjëherë?
- 6 PË. Jo.
- 7 PY. A keni marrë pjesë në Operacionin Shigjeta?
- 8 PË. Jo.
- 9 PY. Po në Kalimash, a keni qenë?
- 10 PË. Jo.
- 11 PY. Po në Gorozhup?
- 12 PË. Jo, as një Gorozhup.
- 13 PY. Faleminderit. Do kaloj në një temë tjetër tani.
- 14 PË. S'ka gjë.
- 15 PY. Sot paradite na thatë që keni qëndruar në fabrikën e
- 16 metalit në Kukës. Iu përgjigje disa pyetjeve që të bëri
- 17 Mbrojtja lidhur me këtë vend. Kam dhe unë disa pyetje shtesë.
- 18 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Dhe për këtë do ju lutesha, të
- 19 nderuar Gjykatës, që të shfaqnim sërish në ekran hartën nga
- 20 ajri për qëllime identifikimi.
- 21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
- 22 mund t'i jepni numrin e referencës Sekretares në mënyrë që ta
- 23 vendosim në ekran?
- 24 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Po. SPOE00330362. Do na
- 25 ndihmonte mbase të jepja numrin e provës materiale, se mbase

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 39

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 tek prova materiale kemi të gjithë gamën e numrave të provave
2 që është P00078. Ju kërkoj falje, sapo kuptova që kam marrë
3 numrin e Zyrës Administrative, që është REG00986 [sipas
4 përkthimit]. Mund të përdorim dhe hartën që ka dhe shënimet.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
6 rregull, pa problem.

7 Sekretare, ju lutem vendosni fotografinë e duhur. Ju
8 faleminderit.

9 Prokurore, fjala është për ju.

10 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

11 PY. Z. Koçinaj, a ka pasur kuzhinë brenda fabrikës së metalit
12 të Kukësit?

13 PË. Kuzhinë nuk më kujtohet vallahi që ka pasë, unë kam pasë
14 vetëm prej 1 ku kam ba unë deri te 2 kam hi. Aty kam qëndru.
15 Kur kam pasë për nevojat e mia diçka, unë jam dalë në qytet.

16 PY. Pra, nëse e kuptova siç duhet. Ku hanit, ku haje, ku haje
17 gjatë kohës që qëndroje dhe punoje në fabrikën e metalit në
18 Kukës?

19 PË. Unë kam ndjetë në Lagje të Re, e kam pasë familjen aty
20 dhe kam shku aty dhe kam hëngër bukë.

21 PY. Çdo ditë --

22 PË. Çdo ditë, po.

23 PY. -- shkoje, domethënë çdo ditë dilje nga fabrika?

24 PË. Po, çdo ditë, kam dalë, kam ardhë.

25 PY. Z. Koçinaj, shohim hartën që kemi përballë në ekran. Ju

1 keni shënuar me numrin 2 magazinën ku punonit, kështu?

2 PË. Po.

3 PY. A shikon në këtë hartë edhe një ndërtesë tjetër që është
4 ngjitur me atë që e ke shënu me numrin 2. A e di se çfarë
5 është ajo ndërtesë që është në të majtë të numrit 2?

6 PË. Unë nuk kam ditë çka është, vetëm unë po e di që këtu te
7 dyshi që kam ndejtë, andejna nuk po e di, s'po më kujtohet që
8 ka qenë. Ndoshta është kanë krejt, komplet, e kam harru qe 25
9 vjet kjo punë. Nuk po e di. Vetëm e di që qetu kam -- qe aty
10 kam punu, te qe ky ku kam bo numrin 2.

11 PY. Z. Koçinaj, ku mbaheshin ushqimet dhe armët që vinin në
12 fabrikën e metalit në Kukës, ku mbaheshin ato? A e din?

13 PË. Armë aty ku kam punu unë nuk ka pasë, vetëm uniforma kam
14 pasë.

15 PY. Z. Koçinaj, a ka pasë banja, tualete, aty në ndërtesë, në
16 ato ndërtesa?

17 PË. Këtu ku kam punue unë, jo.

18 PY. Ku shkonit për nevojat -- për në banjë, për shembull, z.
19 Koçinaj? Kur kishit turnin tuj atje në punë, në fabrikën e
20 metalit?

21 PË. Unë kam dalë. Prej atyjshi kam shku në qytet.

22 PY. Pra, po na thoni që sa herë që kishit nevojë me shku në
23 banjë, shkonit në qytet?

24 PË. Po, afër e kam pasë unë shtëpinë aty, banesën, edhe kam
25 shku në shtëpi.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 41

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
2 falni që po ju ndërpres. Desha të di, Dëshmitar, sa larg ishte
3 shtëpia juaj prej vendit ku ke punu, z. Dëshmitar?

4 DËSHMITARI: Shumë afër e kam pasë. Për dhjetë minuta kam
5 shku.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Vazhdoni, znj. Prokurore.

8 Z. Dëshmitar, ju kujtoj që duhet të thoni të vërtetën.

9 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

10 PY. Z. Koçinaj, atëherë, a ju kam kuptu drejt që sa herë
11 kishit nevojë me shku në banjë, ju shkonit 20 minuta shku e
12 ardhë, nga fabrika e metalit në shtëpi, brenda orarit të
13 punës?

14 PË. Po.

15 PY. A keni pyet ndonjë herë nëse ka pasë banja aty në ato
16 ndërtesa?

17 PË. Unë nuk i kam pyet kurrkënd a ka pasë banja aty a s'ka
18 pasë. Unë edhe tregova që unë veç i kam dhanë uniformat, kanë
19 ardhë i kanë marrë uniformat e kanë shkue. Asnjë send tjetër.
20 Unë kam qeta çka di po të tregoj.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
22 kujtoj dhe një herë z. Dëshmitar, që duhet të thoni të
23 vërtetën. Edhe një herë, po ju kujtoj, dhe mendohuni për këtë.

24 DËSHMITARI: Të vërtetën po tregoj, Gjyqtare. Unë po
25 tregoj të vërtetën për vete, unë çka kam --

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 42

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A ka
2 pasë ndonjë arsye të veçantë pse nuk ke pyet a ka pasë apo
3 s'ka pasë banja aty në ato ndërtesa, në atë vend?

4 DËSHMITARI: Unë e kam pasë punën vetëm me Rexhep
5 Kelmendin, i Pejës ka qenë ai. Vetëm me atë kam pasë punë,
6 s'kam pasë punë me asnjë njeri tjetër aty. Atë kam pyetë, a të
7 dal a të mos dal. Edhe domethënë faktikisht unë, q'aty ka qenë
8 ajo krejt.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po me
10 këtë që thatë nuk iu përgjigjët pyetjes time. Unë vetëm po
11 përpiqem me kuptu, pse ke shku, ndoshta ke pasë ndonjë arsye
12 mjekësore, shëndetësore, se -- edhe ndoshta për këtë arsye
13 shëndetësore nuk doni me e thanë këtu publikisht, por për atë
14 mund të hyjmë në seancë private, por a ka pasë ndonjë arsye të
15 veçantë pse nuk keni shku në tualetet apo në banjat që ishin
16 në ato ndërtesa. Ju thatë që nuk dinit a kishte a s'kishte
17 tualete aty. Pra, vetëm thjesht -- ju lutem prit -- më lejoni
18 të flas edhe mos më ndërprisni sepse pastaj nuk shpjegohemi
19 dot.

20 Pra, unë po përpiqem me kuptu, pse nuk shkoje në banjo
21 aty në atë vend, sepse do të ishte një diçka shumë normale që
22 në një vend si ky të kishte të paktën një tualet, një banjë.
23 Nuk është gjë që ta merr mendja që shkon diku tjetër për me
24 shku në banjo. Pra, që nuk është aty. Thjesht po i quj gjanat
25 ashtu siç janë. Pra, ju jeni këtu me dhanë përgjigje, ju dhatë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 43

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 përgjigje, por duhet të jepni përgjigje të vërtetë, të thoni
2 të vërtetën.

3 Pra, a ka ndonjë arsye pse nuk keni shku në banjë aty me
4 atë vend?

5 DËSHMITARI: Ndoshta ka pasë banja, por unë s'po më
6 kujtohet, znj. Gjyqtare. S'është tu mu kujtu.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ja
8 jap fjalën znj. Prokurore. E kemi shënuar atë që sapo na
9 thatë.

10 Znj. Prokurore, mund të vazhdoni.

11 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit.

12 PY. Z. Koçinaj, sapo na thatë në faqen 36, rreshti 18, se aty
13 ku keni punu ju, nuk kishte armë. Aty ju thjesht jepnit
14 uniforma. A e dini nëse vinin armë edhe ushqime aty në
15 fabrikën e metalit në Kukës?

16 PË. Në këtë fabrikë kanë ardhë vetëm uniforma. S'jam kanë
17 përgjegjës për armë, nuk jam kanë përgjegjës për asnji send,
18 jam kanë përgjegjës vetëm për uniformë me ia dhanë ata që janë
19 -- që kanë ardhë aty.

20 PY. E kuptoj që ishit përgjegjës veç për uniformat, por po ju
21 pyes vetëm nëse kishit dijeni a kanë pru armë aty, a kanë
22 ardhë armë?

23 PË. Nuk e di. S'kam dijeni.

24 PY. A e dinit nëse ka ardhë ushqim aty në fabrikën e metalit
25 në Kukës?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 44

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 PË. S'po më kujtohet. Ndoshta ka ardhë, por s'është tu mu
2 kujtu kjo.

3 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar.

4 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Tani do t'i tregoj dëshmitarit
5 disa fotografi dhe me lejen tuaj, të nderuar Gjykatës, do të
6 vazhdoj të kërkoj nxjerrjen e tyre në ekran. Këto janë me të
7 njëjtën numër ERN që përdori edhe Avokati Mbrojtës.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ta
9 lejoj këtë, por vetëm një vërejtje, një koment kam për
10 dëshmitarin.

11 Është pyetje në fakt. Sa muaj keni punu në këtë magazinën
12 numër 2?

13 DËSHMITARI: Prej fillimit deri në mbarim. Nuk më kujtohet
14 kështu me data me --

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Prej
16 fillimit deri në fund?

17 DËSHMITARI: Po, deri sa jam kthyer në Kosovë.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë
19 kujtoj që keni thënë se ka qenë përpara se të fillonte
20 bombardimi i NATO-s. Po ta them pak më ndryshme. Pra a po
21 thoni që keni qenë atje disa muaj?

22 DËSHMITARI: Po.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe a
24 po thoni që gjatë atyne disa muajve, nuk keni pa asnjëherë
25 gjatë ditës, kur keni punu atje, që të ketë ardhë ushqim në

1 atë vend ku keni punu?

2 DËSHMITARI: Ndoshta ka ardhur ushqim, por s'po më
3 kujtohet. Gjyqtare, unë vetëm kam pasë punë veç me uniformat,
4 s'po më kujtohet për ushqim. Ndoshta ka pasë ushqim, por
5 s'është tu mu kujtu.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
7 po flas vetëm për ato gjënat që keni qenë përgjegjës ju, por
8 po flas për ato që keni pa.

9 Do t'ju bëj një pyetje tjetër. A keni probleme me
10 kujtesën në përgjithësi?

11 DËSHMITARI: Po kam harru, qe sa vite kjo punë, kam harru.
12 Mu po më kujtohet vetëm ajo puna jeme ça kam punu unë, tash
13 ato të tjerat s'po më kujtohen.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Apo
15 nuk doni me folë për gjana të tjera?

16 DËSHMITARI: Jo, nuk e di. Se foli nëse e di, foli.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
18 kujtoj që sigurisht nëse nuk ju kujtohet, nuk duhet të thoni
19 gjë. Por ju lutem përpiquni sa ma shumë me i kujtu gjanat,
20 sepse kjo është arsyeja pse keni ardhë këtu, dhe këtë detyrë
21 keni që të na thoni për gjanat që ju kujtohen.

22 Znj. Prokurore mund të vazhdoni.

23 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Atëherë, të marrim materialin
24 numër 5 në listën e materialeve tona që është SPOE40010264
25 deri në faqen 40010559. Ju lutem, nëse mund të më ndihmoni të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 46

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 nxirrni fotografinë numër 34 që mbaron me 297.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
3 vazhdoni znj. Sekretare.

4 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

5 PY. Z. Dëshmitar, a e njifni këtë fotografi?

6 PË. Po.

7 PY. Çfarë është kjo?

8 PË. Hymja ka kanë, me një anë te magazina.

9 PY. Çfarë -- atëherë, a mund të na konfirmoni që kjo është
10 hyrja që e keni shënuar me numër 1 tek ajo pamja që pamë
11 përpara, tek harta që pamë përpara?

12 PË. Po.

13 PY. Faleminderit.

14 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Ju lutem, a mund të nxjerrim në
15 ekran faqen 12 të këtij dokumenti.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 Përsëri për ta parë nëse e njeh këtë pamje.

18 Ju lutem, Sekretare nxirreni këtë pamje në ekran.

19 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

20 PY. Z. Dëshmitar, ju e identifikuat këtë pamje, këtë
21 fotografi, dhe më herët, sot në mëngjes. Por desha të
22 konfirmoni, ju lutem, a mund të na thoni dhe një herë çfarë
23 tregohet, çfarë është kjo fotografi?

24 PË. Qetu unë kam punue. Qe ky është që e dhashë ma herët në
25 dëshmi.

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 47

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 PY. Faleminderit.

2 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Ju lutem, a mund të dalë në
3 ekran faqja 156 e të njëjtit dokument.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
5 lutem, znj. Sekretare.

6 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

7 PY. Dëshmitar, a e njihni këtë fotografi, këtë pamje?

8 PË. Jo.

9 PY. A nuk ju kujton diçka?

10 PË. Kur kam shku qetash kur kemi qitë atë pllakatën aty, kur
11 kena hi aty, po më duket sikur ajo që kam pa te magazina. Mbas
12 luftës, domethënë kur kemi qitë pllakën aty te dera, që e
13 pashë pak ma herët.

14 PY. A mund të na sqaroni, ju lutem, çfarë doni me thanë, "kur
15 shkumë ta vëmë pllakatën që kemi pa ma parë", a mund të na e
16 shpjegosh për çfarë e ke fjalën?

17 PË. Kur kena shku me vënë pllakatën aty, që kemi ndejtë,
18 domethënë faktikisht mandej kam hi nëpër repart e kam pa. Po
19 më kujtohet sikur qe kjo qaty, ndoshta.

20 PY. Ndoshta ka ndonjë gabim në transkript kur thoni që kena
21 hi q'aty, a për çfarë e keni fjalën?

22 PË. Te magazina.

23 PY. Pra, a është kjo magazina ku ke punu ti?

24 PË. Jo.

25 PY. A ka pasë edhe ndonjë magazinë tjetër në fabrikën e

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 48

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 metalit në Kukës?

2 PË. Qe ajo që ka qenë në ballë, te dyshi ku kam shkrujt unë.

3 Qe kjo s'po më kujtohet.

4 PY. Por, numri 2 është vendi ku ke punu ti, apo jo?

5 PË. Po qeto s'i kam pa unë. Qeto nuk i kam pa.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A

7 është diçka që mund të thuhet në prani të dëshmitarit?

8 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Për ta sqaru dhe për të qenë të

9 drejtë me dëshmitarin, a mund të shpjegohet se kur është marrë

10 kjo fotografi? Kjo është marrë shumë më vonë se sa ka qenë ai

11 aty.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

13 Por znj. Prokurore nuk po flet për gjërat aty brenda, por për

14 ndërtesën vetë. Por megjithatë ia vlen të përmendet se kur

15 është bërë kjo fotografi.

16 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Po, patjetër. Kjo është --

17 fotografi është bërë në vitin 2009. Do ta kontrolloj edhe

18 njëherë. Në fakt është marrë në maj 2019 kjo -- është bërë kjo

19 fotografi.

20 PY. Pra, kjo nuk ka qenë në kohën kur keni qenë ju aty z.

21 Dëshmitar. Megjithatë, ju duket sikur e njihni këtë hapësirë

22 si një hapësirë ku ke qenë ti aty, a është e saktë kjo?

23 PË. Mu s'po më kujtohet, qeto sende s'i kam pa unë. Qeto që

24 janë -- qeto, gjëra s'i kam pa aty. Qe s'po muj me i

25 identifiku tash tamam, kështu. Qeto s'kanë qenë.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
2 Prokurore, është e rëndësishme - e shikoj z. Avokat që jeni
3 çuar në këmbë - por është e rëndësishme t'ia sqaroni
4 dëshmitarit se çfarë kërkoni prej tij të njohë apo jo, dhe kam
5 përshtypjen që ka një keqkuptim midis gjërave që janë aty
6 brenda dhe vetë ndërtesës.

7 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Po, do ta sqarojmë.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Avokat, keni fjalën.

10 Z. AOUINI: [Përkthim] Vetëm për sqarim të mëtejshëm, dhe
11 për të dhënë një informacion. Pyetja ishte "Kjo është një
12 hapësirë ku keni qenë ju".

13 Dhe kur dëshmitari u përgjigj, tha që për vendosjen e një
14 pllakate, a po flasim për ndonjë ngjarje tjetër apo një rast
15 tjetër se për çfarë e ka fjalën? Unë kam një ide, por ndoshta
16 kjo pyetje mund t'i bëhet më mirë dëshmitarit.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ne do
18 të vazhdojmë ta shikojmë. Do t'ia jap fjalën Prokurores dhe të
19 shikojmë nëse dëshmitari do ta njohi apo jo atë që do t'i
20 pyetet.

21 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

22 PY. Pyetja ime ishte: A e njihni këtë ndërtesë, këtë hapësirë
23 dhe jo ato gjanat që janë aty brenda. Jo sendet që janë aty
24 brenda. Dhe ju i dhatë përgjigje kësaj pak ma herët që -- ky
25 ishte ku keni qenë për të vendosur këtë pllakatën. A është e

1 saktë kjo?

2 PË. Po pllakatën qetu s'e kena vendosë ne. Pllakata është
3 jashtë atje te dera e hymjes. Qeto muret e qeto sendet që po i
4 shoh këtu unë nuk i kam pa, unë nuk po e di tash -- nuk po më
5 kujtohet qe ky vend -- ose qite hapësirën mirë, ta shoh prej
6 përjashta, se kështu mbrenda s'po më kujtohet mu. S'po më
7 kujtohet që ka pasë qesi gjana, qesi elementa aty mbrenda. Aty
8 kena pasë vetëm uniforma. E nuk --

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Okej,
10 në rregull z. Dëshmitar. Pyetja është, edhe unë desha të di
11 për vete pastaj do t'ia jap fjalën Prokurores. Unë thjesht du
12 me kuptu nëse e njihni apo nuk e njihni pjesën e brendshme të
13 kësaj ndërtese, pra dritaret, muret, pjesën aty në fund, ato
14 dy dyert, tavanin, kulmin. Nuk du me ditë për ato gjënat që
15 janë aty brenda, veç du me ditë nëse kjo është ndërtesa ku ke
16 punu? Veç kaq desha me ditë. Apo ta them pak më ndryhme? A e
17 njihni këtë ndërtesë, a është kjo ndërtesa që keni punu ju? Në
18 këtë ndërtesë? Dhe -- ju lutem prisni -- dhe mos iu rrotulloni
19 pyetjes. Ose më mirë, përgjigjes.

20 DËSHMITARI: Mu s'po më vjen qe ky -- qe kjo magazina ku
21 kam punue, nuk po muj me e dallu këtu me këto sendet, a po
22 kupton, se unë nuk kam pa kësi gjana aty mbrenda. Kësi gjana
23 për -- domethënë faktikisht nuk po mundem me dhanë përgjigjen
24 e saktë, se nuk po e di qeto që kanë qenë mbrenda. Qitma prej
25 përjashtë, unë menjherë ta tregoj. Edhe mandej unë e di.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 51

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Atëherë po e lë me kaq. Dëshmitar, e kam shënu përgjigjen tuaj
3 që keni dhënë deri tani. Por do t'ia jap fjalën Prokurores që
4 të vazhdojë me pyetjet.

5 Megjithëse, jo. Jo, prit se kam dhe një pyetje tjetër për
6 ju. Kur po diskutonim këtë pllakatën, aty para ndërtesës, a
7 keni shku brenda kësaj ndërtese kur ishte vu kjo pllakata --

8 DËSHMITARI: Po.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] --
10 dhe jashtë ndërtesës?

11 DËSHMITARI: Po.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,
13 sigurisht që keni shku mbrenda, por nuk mund të konfirmoni që
14 kjo ndërtesë, ose kjo pamje -- ose ta them ndryshme. Pra,
15 ndërtesën e njeh si ndërtesa ku ke shku atë ditë kur është
16 vënë pllakata jashtë kësaj ndërtese?

17 DËSHMITARI: Po.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe a
19 të kujtohet nëse kjo ndërtesë nga brenda, a ishte kjo ndërtesa
20 ku ke punu ti gjatë asaj kohe kur ke qenë në magazinën 2?

21 DËSHMITARI: Ndoshta është që kjo, po s'po më -- me këto
22 sendet s'po muj me -- me këto materialet mbrenda që janë s'po
23 mundem me e kapë. Ndoshta është që kjo ndërtesa, ndoshta.
24 Ndoshta është që kjo magazina ku kam punu.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 52

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 Dëshmitar, thjesht po përpiqem me sqaru, me kuptu. Nuk du që
2 të japësh përgjigje siç e dunë këta në të majtë apo në të
3 djathtën tënde. Pra, thjesht po përpiqem me kuptu ke shku tek
4 këto -- tek kjo ndërtesë e kësaj fabrike, për me vendosë këtë
5 pllakatë aty.

6 DËSHMITARI: Po.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
8 kur ke shku atje, te ky vend, dhe ke shku te kjo ndërtesë nuk
9 të kujtohej nëse ka qenë kjo ndërtesa ku ke punu. Këtë desha
10 me ditë?

11 DËSHMITARI: Nuk po më kujtohet, Gjyqtare, geto. Ndoshta
12 është qe kjo ndërtesa, në bazë të përjashte, qysh po shifet
13 është kjo ndërtesa, por me geto mbrenda, me geto më ka hupë ai
14 orientimi. Nuk po muj me dallu tash.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Vazhdoni, znj. Prokurore. Jua lë juve të vazhdoni me pyetjet.

17 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
18 Gjykatëse.

19 A mund të vendoset një fotografi tjetër, që është në
20 faqen 157?

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
22 mund të na sqaroni për çfarë qëllimi po e vendosni këtë
23 fotografi?

24 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Për qëllime identifikimi.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 53

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 Vazhdoni, znj. Sekretare mund ta nxirrni pamjen në ekran.

2 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

3 PY. Z. Koçinaj a e njihni këtë fotografi?

4 PË. A ka mundësi me e zvogëlu ma shumë? Me e zvogëlu pak?

5 S'mundem me dallu derën.

6 PY. A është më mirë kështu, tani?

7 PË. Jo, nuk e ka zvogëlu hiç.

8 PY. Z. Dëshmitar, unë -- ju thatë që "Nuk jam i sigurt a

9 është dera", për çfarë dera e keni fjalën?

10 PË. Dera e magazinës.

11 PY. Ku ishte kjo dera e magazinës?

12 PË. Qe kjo nuk po më kujtohet.

13 PY. A ka qenë brenda ndërtesës apo jashtë ndërtesës?

14 PË. Brenda ndërtesës. Prej hymjes kryesore ka qenë drejt.

15 PY. Ku ishte kjo derë brenda magazinës? A e ke kalu

16 ndonjëherë këtë derë? A ke hy në këtë derë?

17 PË. Nuk po më kujtohet qe kjo dera.

18 PY. Por ty t'u kujtu kjo dera, po e njeh çfarë është?

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

20 Prokurore, po shoh që Avokati Mbrojtës është çuar në këmbë. Ju

21 keni fjalën.

22 Z. AOUINI: [Përkthim] Më falni për ndërprerjen, besoj që

23 ka një ngatërresë këtu sepse dëshmitari i thotë -- flet për të

24 gjithë atë vendin atje. Të gjithë asaj i thotë magazinë. Kur

25 ai kërkoi që të zvogëlohej, kur tha që -- kur tha këtu për

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 54

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 brenda magazinës, ndoshta ai e ka fjalën për të gjithë
2 mjediset atje.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
4 të vazhdohet, por unë e mbaj mend që Prokurorja tha, e pyeti,
5 brenda apo jashtë, dhe ai tha brenda, dhe nuk besoj që e ka
6 fjalën për jashtë atyre mjediseve, ambienteve atje. por
7 megjithatë, për sqarim më mirë ta bëjmë edhe njëherë këtë
8 pyetje.

9 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Ta bëj pyetjen ndryshe, por sot
10 në mëngjes dëshmitari e njohu këtë derë nga oborri,
11 megjithatë, ta bëjmë edhe një herë këtë pyetje.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sa
13 për të mos pasur ndonjë keqkuptim, ju lutem a mund ta bëni
14 edhe një herë pyetjen siç e mendoni të nevojshme.

15 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Mirë atëherë, po ju pyes nëse
16 fotografia që pamë sot paradite, më falni, do ju lutesha
17 Sekretares të shfaqë edhe një herë fotografia që i treguam sot
18 paradite dëshmitarit, ka numër REG00970.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Vazhdoni, Sekretare.

21 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

22 PY. Z. Dëshmitar, sot paradite shënuat me numër 4 hymjen,
23 hymjen për në magazinë, kështu?

24 PË. Po, qe kjo është, me numër 4.

25 PY. Nga kjo deri hynit për në magazinë kur shkonit në punë?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 55

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 PË. Po, nga kjo derë kam hy.

2 PY. Kjo dera këtu, është e njëjta -- është e njëjta derë me
3 derën që pamë te fotografia para kësaj.

4 PË. Ajo nuk po më kujtohet. Qe kjo po, qe kjo po, e di se
5 kështu është me numër katër. Jam hi mbrenda, qe kjo dera po më
6 kujtohet. Ajo dera tjetër s'po muj me kuptu ku është. A kë po,
7 me numër 4, po.

8 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua të
9 sqarojmë dhe diçka lidhur me këtë aspekt. Pastaj do më duhet
10 të nxjerrim edhe një herë hartën me pamje ajrore të fabrikës.
11 Dhe për këtë qëllim mund të jap dhe numrin, numrin e provës
12 materiale P0078. Dhe ka marrë numër nga Zyra Administrative,
13 sot i njëjti material, REG00968.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
15 të vazhdoni.

16 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

17 PY. Z. Dëshmitar, në këtë hartë shohim magazinën me numër 2,
18 ku thatë se këtu keni punu. Pak më përpara unë ju pyeta nëse e
19 njihnit ndërtesën ngjitur, që është ndërtesa në të majtë,
20 majtas numrit 2, ju u përgjigjët se nuk e dinit çfarë ishte
21 kjo ndërtesë. Dinit vetëm, njihnit vetëm, magazinën me
22 uniforma.

23 Z. GILISSEN: [Përkthim] Me lejen tuaj, kam diçka për të
24 thënë. Dua të shpjegoj diçka pa praninë e dëshmitarit.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 56

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 rregull.

2 Z. Dëshmitar, Asistentja do ju shoqërojë jashtë sallës së
3 gjyqit tani, sa të diskutojmë diçka lidhur me pyetjet. Për
4 pesë minuta do ju thërrasim sërish.

5 DËSHMITARI: [E pakuptueshme] Okej.

6 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Fjala
8 është për ju.

9 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit. Dua të fokusohemi
10 në diçka me Trupin Gjykses. Nëse shohim fotografinë ajrore që
11 kemi në ekran, kemi thënë që magazina ka numër 2. Por kjo këtu
12 nuk është fotografia e magazinës numër 2.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
14 dimë ne këtë.

15 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, por ne kur shkuam atje -- nuk
16 dua të ndikoj te dëshmitari --

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, e
18 di çfarë po përpiqesh të thuash.

19 Z. GILISSEN: [Përkthim] -- kur shkuam ne dyert ishin
20 komplet të hapura, dhe në realitet nuk dukej kështu. Unë s'e
21 kuptova që kjo porta e madhe ishte kaq gjigante, se ishte e
22 mbyllur. Dhe ne na u duk sikur ishte pjesë e një korridorit.
23 Unë kur shoh ndërtesën numër 2 -- dhe them që ana tjetër e
24 dritares mund të jetë pjesa ku ka qenë magazina.

25 Por, me sa duket, ju e keni kuptuar shumë mirë kështu që

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 57

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 nuk dua ta zgjas më tej.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
3 mirë bëtë që e ngritët këtë gjë, që ta sqarojmë për të gjithë.
4 Se mbase do e bënim më të vështirë. Kështu që lirisht çdo herë
5 mund t'i ngrini këto paqartësi. Më mirë t'i diskutojmë me
6 njëri-tjetrin.

7 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, po, e kam të qartë.

8 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Thjesht për t'u
9 kundërpërgjigjur. Do ta marrim parasysh, ne nuk kishim për
10 qëllim ta çorientonim dëshmitarin duke i treguar një fotografi
11 ku në të vërtetë s'kishte punuar. Ne thjesht e pyetëm a e njeh
12 këtë ndërtesë, sepse ka disa gjëra që ne po përpiqemi të
13 konfirmojmë. Vetëm për këtë arsye e pyetëm, megjithatë, e
14 marrim parasysh atë që tha Avokati.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të
16 paktën për Trupin Gjykes, të paktën ne si Trup Gjykes nuk
17 menduam se i bëtë ndonjë pyetje çorientuese.

18 Në rregull, atëherë. Vazhdojmë.

19 Ju lutem, t'i thoni Asistentes të sjellë dëshmitarin në
20 sallë.

21 [Dëshmitari vijon dëshminë]

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
23 se erdhët.

24 DËSHMITARI: Faleminderit.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po ia

1 jap sërish fjalën Prokurores që të vazhdojë me pyetjet e veta.

2 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

3 PY. Z. Dëshmitar, po flisnim për ndërtesën që shohim në këtë
4 imazh. Ndërtesën ngjitur me atë që ju keni shënuar si numër 2.
5 Ju na thatë që nuk e dinit çfarë ishte kjo ndërtesë, kështu,
6 saktë?

7 PË. Jo, dyshin e di çka është.

8 PY. Mbase s'u kuptuam. Jo, e kemi fjalën për ndërtesën në
9 krah, në krah. Që është si ngjyrë gri e çelët. Në të majtë. Jo
10 ndërtesa që ke shënuar numër 2, ndërtesa në krah. Saktë?

11 PË. Po? Po kjo ndërtesa ka qenë e ngjitme krejt komplet.

12 Ndërtesa me numër 2 ka qenë ngjitë me këtë krejt komplet. Me
13 q'atë derën ka qenë, me numër 2.

14 PY. Faleminderit. Pra, ajo dera për të cilën po flisnit ju,
15 mos është ajo porta e metalit, nëse mund ta shprehim, mos
16 është ajo porta e metalit që pamë te ajo fotografia më
17 përpara?

18 PË. Jo, nuk më kujtohet ajo dera. Nuk po e di ku është ajo.

19 Unë kam hi prej qesaj, qe asaj derës që ta kam dhanë numër 2.

20 Edhe qe kjo ndërtesa këtejna që ka qenë, që është, është e
21 ngjitme krejt komplet ka qenë. Nuk më kujtohet ajo, ndoshta ka
22 pasë derë aty, por s'më kujtohet.

23 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Mbase mund t'i kërkojmë

24 dëshmitarit t'i vendosë një numër pjesës tjetër të ndërtesës,

25 se do na shërbejë për pyetjet e ardhshme.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 59

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

2 Dëshmitar, a mund të shënoni ndërtesën ngjitur, ngjitur me

3 ndërtesën ku ke punuar, ju lutem me numrin 5. Ndërtesën

4 ngjitur me ndërtesën ku ke punuar.

5 DËSHMITARI: Qe kjo.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Faleminderit. Shumë e qartë.

8 Sekretare, ju lutem ruajeni këtë imazh dhe jepini numrin

9 përkatës.

10 [Anëtarët e Trupit Gjykses dhe Sekretarja e

11 Gjykatës këshillohen]

12 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Të vazhdoj?

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

14 Prokurore, prisni ju lutem. Duhet që t'i japim numrin

15 përkatës. Janë çështje administrative, përfundojmë me këtë hap

16 dhe pastaj vazhdojmë.

17 [Anëtarët e Trupit Gjykses dhe Sekretarja e

18 Gjykatës këshillohen]

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kemi

20 një problem teknik, do t'i kërkojmë teknikëve të kompjuterëve

21 që të vijnë. Duhet të kemi pak durim.

22 [Anëtarët e Trupit Gjykses dhe Sekretarja e

23 Gjykatës këshillohen]

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sapo

25 më informuan që po vijnë teknikët e kompjuterëve, të IT-së për

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 60

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 ta zgjidhur këtë problem.

2 [Anëtarët e Trupit Gjykses dhe Sekretarja e
3 Gjykatës këshillohen]

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ja
5 presim nëse zgjidhet shpejt e shpejt. Përndryshe do bëjmë
6 pushimin. Nja pesë a dhjetë minuta. Vetëm një orë kemi punuar,
7 nuk do doja që ta merrnim që tani pushimin.

8 Z. Dëshmitar, ju lutem pak durim.

9 DËSHMITARI: S'ka problem, Gjyqtare, s'ka problem hiç.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Nuk ka
11 përkthim]

12 [Anëtarët e Trupit Gjykses dhe Sekretarja e
13 Gjykatës këshillohen]

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
15 duhet të ndërpresim seancën për momentin. Fillimisht, do
16 shoqërojmë dëshmitarin jashtë sallës së gjyqit.

17 Z. Dëshmitar, do ju shoqërojmë jashtë sallës derisa të
18 zgjidhim problemin teknik.

19 DËSHMITARI: Ju faleminderit, Gjyqtare.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ju
21 shoqërojë Asistentja.

22 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sapo
24 të zgjidhet problemi teknik, do kthehemi në sallë dhe do
25 vazhdojmë seancën.

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 Për momentin seanca ndërpritet.

2 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.24

3 --- Seanca rifillon në orën 14.00

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
5 se erdhët pas pushimit.

6 Po shoh që Prokuroria ka të njëjtin ekip. E njëjta gjë
7 Mbrojtësi i Viktimave. Në të majtë Mbrojtja, a është me të
8 njëjtin numër personash?

9 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jemi të njëjtët persona, me
10 përjashtim të znj. Carilou që nuk mund të merrte pjesë në
11 seancën e pasdites.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
13 ashtu z. Shala është i pranishëm. Z. Shala, më dëgjoni?

14 I AKUZUARI: [përmes videolidhjes] Po, ju dëgjoj fort
15 mirë.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Faleminderit.

18 Përpara se të fillojmë, dua të diskutoj nja dy çështje.
19 Do t'ua jap fjalën, avokatë, për diçka që deshët të
20 diskutonit. Por përpara, do të diskutojmë numrin e një nga
21 dokumentet sepse ishim duke ruajtur një dokument që t'i jepnim
22 numrin. Pra para pushimit, kur po bënte pyetjet Prokuroria,
23 dëshmitari bëri një shënim shtesë tek një material. Dhe
24 materiali në fakt e kishte marrë një numër sot gjatë pyetjeve
25 që kishte bërë Mbrojtja, dhe ka marrë numrin REG00968, ky

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 dokument.

2 Sekretarja po e ruante dokumentin me shënimin e ri, në
3 atë moment na ndodhi ky problemi teknik. Na u desh ta
4 ndërprisnim seancën.

5 Kompjuteri i ruajti automatikisht shënimet që -- pra i
6 ruaji me të njëjtin numër, me REG968. Pra, kemi një dokument
7 tani, kemi një dokument që ka shënimet e Mbrojtjes që ishin me
8 ngjyrë të kuqe, dhe shënime me ngjyrë të zezë gjatë
9 kundërpyetjeve.

10 Pra, meqenëse shënimet u ruajtën në të njëjtin dokument,
11 ne do ta mbajmë një dokument dhe nuk do ta mbajmë këtë
12 fotografi si dy dokumente të ndara. Rrjedhimisht, do të ruajmë
13 materialin me numrin REG00968. Për procesverbal e thashë këtë,
14 që të kuptojmë çfarë ndodhi me dokumentin.

15 Z. Aouini fjala është për ju.

16 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit dhe mirëdita.

17 Duam të trajtojmë për sqarim diçka, [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit.

21 Znj. Prokurore, doni të thoni diçka në lidhje me këtë?

22 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Jo, e vlerësojmë sqarimin. E

23 vlerësojmë sqarimin që dha Mbrojtja lidhur me këtë aspekt.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Mbrojtësi i Viktimave, ka diçka nga ana juaj?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 64

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, asgjë prej nesh.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
3 rregull. Vazhdojmë me kundërpjetet nga Zyra e Prokurorit të
4 Specializuar.

5 Ju lutem sillni dëshmitarin në sallën e gjyqit.

6 [Dëshmitari vijon dëshminë]

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
8 se u kthyet, z. Dëshmitar.

9 DËSHMITARI: Mirë se ju gjeta, Gjyqtare.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Shpresoj të kesh pushuar pak, do vazhdojmë tani me -- do
12 vazhdojmë tani me pyetjet nga Prokuroria, dhe po i jap fjalën
13 që të vijojë.

14 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
15 Gjykatëse.

16 PY. Mirëdita, z. Koçinaj.

17 PË. Mirëdita, Prokurore.

18 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do lutesha
19 që të shfaqej sërish në ekran fotografia që po diskutonim para
20 pushimit. Dhe që i vuri shënimin përkatës dëshmitari,
21 konkretisht materiali me numër REG00968.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
23 lutem vendoseni në ekran, znj. Sekretare.

24 Z. Shala, mos e keni mikrofonin e ndezur?

25 I AKUZUARI: [përmes videolidhjes] Po? Jo.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sepse
2 kemi pak zhurmë në sfond. S'e kuptojmë. Nuk po ju akuzoj pse
3 nuk keni fikur mikrofonin, mos më keqkuptoni, z. Shala. Më
4 falni, thjesht po përpiqem nga po na vjen zhurma, sepse është
5 pak çorientuese.

6 Në rregull. Okej, vazhdojmë.

7 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

8 PY. Z. Dëshmitar, para pushimit po shihnim imazhin që keni
9 përballë, ku ju shënuat me numrin 5 një ndërtesë. Ju na thatë
10 se ndërtesa me numrin 5 ishte ngjitur me ndërtesën numër 2 me
11 një derë të vetme, kështu?

12 PË. Po.

13 PY. Pra, a e kuptoj siç duhet që këto dy ndërtesa kishin një
14 derë të brendshme që i lidhte me njëra-tjetrën?

15 PË. Një derë e brendshme ka qenë, po.

16 PY. Z. Dëshmitar, ju a keni shkuar ndonjëherë te ndërtesa
17 numër 5?

18 PË. Qe kjo që ka qenë e ngjitme? Po, se ka qenë me një derë
19 kjo dhe ka qenë e ngjitme krejt komplet. Nuk ka pasë derë aty
20 në mes, domethënë, ka qenë krejt komplet ndërtesë. Me një derë
21 kam hi, edhe me një derë jam dalë.

22 PY. Faleminderit. Çfarë kishte brenda kjo ndërtesa numër 5?

23 PË. Kjo ndërtesa numër 5 ka pasë uniforma, prej te 2 e deri
24 kjo, komplet ka qenë me uniforma e mbushur.

25 PY. Pra, nëse e kam kuptuar unë siç duhet, ju po na thoni që

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 66

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 këto dy ndërtesa, 2 dhe 5 ishin të mbushura me uniforma?

2 PË. Po.

3 PY. Atëherë, ju punonit në të dyja ndërtesat?

4 PË. Unë kam punu te qe kjo ndërtesa, por kjo ka qenë e
5 ngjithmë krejt komplet. Nuk ka pasë derë aty, domethënë, kam hi
6 te dera numër 2, edhe kam lëvizë, domethënë, e deri te kjo
7 ndërtesa tjetër. Nuk ka pasë derë aty.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ta
9 sqarojmë, ta kuptojmë, z. Dëshmitar. Kur thoni ju s'kishte
10 ndarje, derë? Ose jo, më falni, ta bëj pyetjen ndryshe.
11 S'kishte ndarje mes kujt? S'kishte derë mes kujt?

12 DËSHMITARI: Mes asaj 2 edhe 5. Unë kam hi me një derë,
13 domethënë faktikisht edhe kam lëvizë domethënë nëpër magazinë.
14 Nuk ka pasë ndarje.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
16 faleminderit. Faleminderit, z. Dëshmitar.

17 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

18 PY. Z. Dëshmitar, sot paradite thatë se vendi ku punonit ju,
19 që me sa kuptoj unë bëhet fjalë dhe për ndërtesën 2 dhe për
20 ndërtesën 5, ju thatë që nuk kishte armë, dhe se ke qenë
21 përgjegjës vetëm për uniformat.

22 PË. Po.

23 PY. Megjithatë, me sa dini ju, a kishte armë në fabrikën e
24 metalit?

25 PË. Nuk e di. Nuk më kujtohet që ka pasë armë aty në fabrikën

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 67

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 e metalit.

2 PY. Por fabrika e metalit në Kukës a përdorej për ushtarët e
3 UÇK-së dhe luftëtarët?

4 PË. Po.

5 PY. Ju po thoni që luftëtarët nuk kishin armë për të luftuar?

6 PË. Aty kur kanë ardhë prej mërgimit, prej shteteve të tjera,
7 prej Kosovës, aty kanë ardhë civilë, janë veshë, i kanë marrë
8 uniformat tona dhe janë dalë. Kur kanë marrë armët, ça kanë
9 ba, nuk e di. S'jam kanë përgjegjës për atë punë. Jam kanë
10 përgjegjës vetëm me ia dhanë uniformën, edhe me shku.

11 Ku kanë shku ma andej ata, nuk e di, nëpër -- s'më ka
12 interesu ma ajo punë.

13 PY. Faleminderit. Tani do të doja të shihnim një imazh
14 tjetër.

15 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Gjithashtu për qëllim
16 identifikimi. Të nderuar Gjykatës, mund të heqim nga ekrani
17 imazhin që e kemi përpara dhe do ju lutesha të shihnim disa
18 nga fotografitë që pamë pak më herët.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Sekretare, vendosni në ekran fotografitë që i nevojiten
21 Prokurores.

22 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Dokumentat janë me numrat
23 SPOE40010264, 240010559 [sipas përkthimit]. Në ekran më
24 nevojitet fotografia që mbaron me 290 ose faqja 27.

25 PY. Z. Dëshmitar, a e njihni këtë fotografi?

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 68

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 PË. Nuk po më kujtohet çka është kjo. Nuk muj me ditë.

2 PY. Faleminderit.

3 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Ju lutem të vendosni në ekran
4 një fotografi tjetër, sërish për qëllime identifikimi, por ka
5 numër ERN tjetër.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Vazhdoni.

8 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Është numri i provës materiale
9 P0093 me ERN 074390-074391, faqja e parë.

10 PY. Z. Dëshmitar, po këtë fotografi, a e njihni?

11 PË. Jo, as këtë nuk e njoh. Nuk po e di çka është.

12 PY. Faleminderit.

13 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Për momentin, mund ta heqim
14 fotografinë nga ekрани.

15 PY. Z. Koçinaj, dëshiroj t'ju bëj disa pyetje lidhur me
16 fabrikën e metalit, organizimin e kësaj fabrike, dhe disa
17 aspekte të tjera në lidhje me të.

18 Së pari, kur punonit në magazinë, gjatë kohës që punonit
19 në magazinë, ose kur mbërritët atje, a patët mundësi t'i
20 vizitonit ndërtesat e tjera, brenda kompleksit, brenda
21 fabrikës?

22 PË. Unë kur kam shkue aty, kam shku drejt qe aty te ku kam bo
23 atë me numër 2, aty kam ndejtë non-stop aty. Qaty ka pasë
24 uniforma, dhe qaty jam kyçë te uniformat edhe s'kam lëvizë më
25 kurrkund prej atyjshit. Vetëm te qe ajo ndërtesa kam qenë.

1 PY. Sot paradite thatë diçka që është reflektuar në faqen 27
2 të transkriptit, rreshtat 15 deri në 17. Pra ju thatë që atje
3 ishte dhe një doktor. Nga e dinit ju që ishte ky doktori në
4 fabrikën e metalit në Kukës?

5 PË. Po, doktori ka ardhë te unë aty në magazinë, e ka marrë
6 uniformën, edhe prej q'atyshit jena njoftu.

7 PY. Faleminderit. Ju thatë se vinin persona në magazinë, për
8 të marrë uniformat, edhe unë tani dëshiroj t'ju pyes: Fabrika
9 e metalit në Kukës a kishte shumë lëvizje?

10 PË. Ka pasë lëvizje, që kanë ardhë prej Perëndimit, edhe prej
11 Kosovës e prej viseve të tjera që janë kyçë në radhët e UÇK-së
12 dhe, domethënë, janë ardhë krejt aty. Dhe ka pasë lëvizje. I
13 kanë marrë uniformat dhe kanë dalë.

14 PY. Përafërsisht, sa persona mendoni se kanë qenë të
15 pranishëm në fabrikën e metalit në Kukës gjatë periudhës kur
16 keni punuar ju atje? Me përafërsi.

17 PË. Qysh kanë mujt me ardhë prej jashtit, 50, 60, 20, qysh
18 kanë mujtë me ardhë. Për çdo ditë ka pasë lëvizje aty, nuk
19 është kanë veç një ditë, por për çdo ditë ka pasë lëvizje që
20 kanë ardhë prej -- në magazinë.

21 PY. Pra, ju po thoni që vinin persona prej jashti, nga
22 Kosova. E dini ku shkonin pasi merrnin uniformat?

23 PË. Jo, nuk e di. I kanë marrë uniformat edhe mu s'më ka
24 interesu ku kanë shku, ata i kanë pasë ato detyrat e veta
25 çdokush.

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 70

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 PY. Ju, a keni parë ushtarë të veshur me uniforma në atë
2 ambient, në atë mjedis?

3 PË. Po, patjetër. Aty janë veshë ata.

4 PY. Ndonjë prej këtyre ushtarëve, a qëndroi -- më gjatë se
5 koha e nevojshme për të marrë uniformën në këtë ambient? Pra a
6 qëndroi ndonjë ushtar më gjatë se ç'duhej?

7 PË. Jo, s'ka qëndru aty, askush. I kanë marrë uniformat dhe
8 kanë shku.

9 PY. Pra, ju po thoni që të gjithë personat që vinin për të
10 marrë uniforma, vinin, merrnin uniformat dhe iknin në të
11 njëjtën ditë?

12 PË. Po. Ka mujtë me ikë, po, të njëjtën ditë kanë ikë. Se
13 s'kanë pasë ku me ndejtë aty, s'ka pasë banim ku me flejtë
14 aty, janë shpërnda, domethënë, nëpër vendet e tjera, ku [E
15 padëgjueshme] nuk e di.

16 PY. A e dini mbase ndonjë nga këta ushtarë, fjeti -- ju
17 kërkoj falje. A e dini në qoftë se ndonjëri prej këtyre
18 ushtarëve fjeti ndonjëherë në fabrikën e metalit në Kukës?

19 PË. Jo. S'ka mujtë me fjetë aty se s'ka pasë kushte.

20 PY. Ju thoni s'kishte kushte në asnjë vend në fabrikën e
21 metalit në Kukës? Në asnjë pjesë të fabrikës së metalit?

22 PË. Unë po foli veçëm për ku kam punu unë, aty nuk ka pasë
23 vende, por tjetërkund ku kanë shkue nuk e di.

24 PY. A keni parë persona që nuk kishin uniforma në fabrikën e
25 metalit në Kukës?

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 71

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 PË. Jo, aty s'ka mujtë me pasë. Kur kanë ardhë, normal që
2 kanë ardhë aty, normal kanë ardhë me tesha kështu, mandej i
3 kanë zhveshë ato teshat, e kanë veshë uniformën dhe kanë shku.

4 PY. Këta personat pa uniforma, vinin brenda në magazinë, atje
5 i keni parë apo jo?

6 PË. Po.

7 PY. Z. Dëshmitar, a ka pasur persona të ndaluar në fabrikën e
8 metalit në Kukës?

9 PË. Jo. Q'aty te unë, jo.

10 PY. A ka pasur persona të ndaluar në ndonjë pjesë tjetër në
11 fabrikën e metalit në Kukës, jo aty ku punonit ju?

12 PË. Nuk e di për tjetërkund, q'aty jo.

13 PY. Faleminderit. Kam disa pyetje për punën tuaj në fabrikën
14 e metalit në Kukës. Si fillim, ju keni qenë personi i vetëm
15 përgjegjës për magazinën?

16 PË. Jo, kam pasë Rexhep Kelmendin që ka qenë përgjegjës për
17 magazinën. S'kam qenë vetëm.

18 PY. Pra keni qenë ju dhe z. Kelmendi, ju të dy punonit në
19 magazinë?

20 PË. Jo, Rexhepi ka qenë mbikëqyrës. Ai ka punue tjetërkund,
21 me një zyrë. Unë kam punu në magazinë. Prej atij i kam marrë
22 urdhnat, kur u ka dashtë me shpërnda uniformat.

23 PY. Më herët thatë se magazina ku punonit ju ishte e ndarë në
24 dy pjesë. Pjesa 2 dhe pjesa 5, të dyja të mbushura plot me
25 uniforma. A keni qenë ju i vetmi person që u shpërndante

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 72

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 uniforma ushtarëve?

2 PË. Jo, kanë qenë nja tre veta të tjerë aty që i ka pru
3 Rexhepi, por nuk e di kush janë me emra ata. I ka pru vetë ai.
4 Tre ushtarë, kanë qenë të UÇK-së ata, dikund të rrethit të
5 Pejës kanë qenë, por nuk e di kush -- s'më kujtohet tash, kam
6 harru kush kanë qenë ata njerëz.

7 PY. Këta personat nga Peja, po ashtu punonin në magazinë?

8 PË. Po, edhe ata kanë punu në magazinë.

9 PY. Pra, edhe ata shpërndanin, u jepnin uniforma rekrutëve të
10 rinj, kështu?

11 PË. Po, të njëjtën punë e kena pasë.

12 PY. Faleminderit. Dua të më përshkruani si ishte një ditë
13 normale për ju në fabrikën e metalit në Kukës. Çfarë ore
14 filloje, në mëngjes? Çfarë ore shkoje në mëngjes?

15 PË. Nga 8.00 ora kam shku gjatë

16 PY. Sa orë punonit?

17 PË. Deri në 16.00, në 17.00, eventualisht, se ka pasë që kanë
18 ardhë prej -- njerëz që vijshin për me marrë uniforma, deri në
19 16.00, 17.00, kam ndejtë aty.

20 PY. Më herët thatë që për të ngrënë shkonit në qytetin e
21 Kukësit --

22 PË. Po, se kam pasë --

23 PY. -- a mund të themi që bënit pushimin e drekës, pra
24 merrnit pushimin e drekës?

25 PË. -- po, kam shku në shtëpi, po.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 73

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 PY. Pasi mbaroni punën, iknit menjëherë nga fabrikën e

2 metalit?

3 PË. Po.

4 PY. Z. Koçinaj, si mbërritën uniformat në fabrikën e metalit

5 në Kukës?

6 PË. I kanë pru krejt prej jashtit, [E padëgjueshme] i kanë

7 pru prej Gjermanie, Zvicra, Italia, të gjithë. I kanë pru

8 shtetet e jashtme. Ka pasë uniforma amerikane, zvicerane, ka

9 pasë uniforma gjermane. Të gjithë i kanë pru aty.

10 PY. Si i kanë transportu, me çfarë i kanë pru aty në fabrikën

11 e metalit?

12 PË. I kanë pru me kamiona, me kamiona.

13 PY. Sa kamiona kanë ardhë çdo ditë, për afërsisht nëse mund të

14 na thoni?

15 PË. S'më kujtohet, nuk e di -- kanë ardhë, por s'po e di sa

16 kanë ardhë.

17 PY. A mund të na e japësh një numër të parafërt, sa për me e

18 kriju një ide.

19 PË. Nuk po më kujtohet, vallahi, sa kanë ardhë, nuk e di.

20 Kanë ardhë, vetëm nuk e di sa kanë ardhë. Se kanë ardhë për

21 çdo ditë.

22 PY. A të ka ndihmu ndokush me i mbartë uniformat, me i futë

23 në magazinë?

24 PË. Po.

25 PY. Kush?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 74

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 PË. Q'ato tre personat që i ka lanë Rexhep Kelmendi aty, ata
2 i kanë shkarku, i kemi rregullu krejt me ata të tre. Katër
3 vetë kemi qenë gjithë në magazinë.

4 PY. Z. Koçinaj, gjysmën e dytë të majit edhe deri në fillim
5 të qershorit 1999, a ke pa ndonjë person të etnicitetit, të
6 etnisë rome në atë fabrikën e metalit në Kukës?

7 PË. Jo.

8 PY. A ke ditë nëse ndonjë muzikant rom, a ka pasë muzikant
9 rom në fabrikën e metalit në Kukës kur ke qenë ti aty?

10 PË. Jo, s'ka pasë. Kur kam qenë unë, jo.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
12 Prokurore, a mund t'i thoni Trupit Gjykues se sa kohë do t'ju
13 duhet për të bërë pyetjet tuaja, dhe sa ju ka mbetur?

14 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës, besoj
15 do të më duhet edhe nja një orë, ose 45 minuta.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
17 rregull. Sepse i keni tejkalu kohën që ju kemi caktu, në
18 parim, sepse marrëveshja është që, pak a shumë, për pyetjet e
19 Prokurorisë duhet t'u jepet kohë pothuajse e barabartë me atë
20 që bën pyetje Mbrojtja.

21 Megjithatë, unë e shoh që pyetjet tuaja kanë lidhje me
22 çështjet, dhe vetëm dua të keni parasysh që po e tejkaloni
23 shumë kohën që ju është caktuar. Por vetëm duhet të na tregoni
24 që këto pyetje janë relevante, kanë lidhje me çështjen.

25 Mund të vazhdoni, megjithatë do të kishte më mirë që të

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 75

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 na kishit thënë për këtë që ta dinim, sepse unë ju kam dhënë
2 pak më shumë kohë, por tani ju po shpenzoni shumë më tepër
3 kohë se sa ju takon.

4 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Patjetër, e nderuar Gjykatëse,
5 ndoshta mund t'i shkurtoj pyetjet e mia.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
7 nuk ishte kjo ideja pse thashë, vetëm që duhet të na jepni një
8 ide se sa kohë do të shpenzoni. Domethënë sepse kjo ka të bëjë
9 edhe me Mbrojtësin e Viktimave dhe me Mbrojtjen, edhe ata
10 duhet ta dinë.

11 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit.

12 PY. Z. Koçinaj, ju na thatë që vinin kamiona me uniforma në
13 magazinë, dhe kjo magazina kishte dy pjesë, të dyja ishin plot
14 me uniforma dhe na thatë që ishin vetëm katër persona, pra ti
15 vetë dhe tre persona të tjerë që i keni shkarku uniformat nga
16 kamionat dhe i keni futë në magazinë. A është kjo që na thatë?
17 PË. Qe kjo është.

18 PY. Z. Koçinaj, a keni dijeni për dy aktgjykime publike që
19 kanë lëshu Gjykata e Rrethit të Mitrovicës dhe Gjykata
20 Themelore e Mitrovicës që kanë dënuar një individ, për Sabit
21 Gecin e kishte, dhe Xhemë Krasniqin, se kanë mbajtur të
22 ndaluar individë në fabrikën e metalit në Kukës, në mënyrë të
23 paligjshme?

24 PË. Q'aty jo.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk e

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 76

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 kuptoj këtë përgjigje.

2 Pyetja është: A keni dijeni që janë dhanë dy vendime
3 gjykatash që janë lëshu nga Gjykata Themelore dhe Gjykata e
4 Qarkut të Mitrovicës që kanë dënuar individë si Sabit Geci dhe
5 z. Krasniqi sepse kanë mbajtur në mënyrë të paligjshme të
6 ndaluar persona në fabrikën e metalit në Kukës?

7 A keni dijeni për këto?

8 DËSHMITARI: I kamë dëgju në televizor.

9 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

10 PY. Por ti nuk ke pa kurrë persona të mbajtur të ndalumë aty
11 në fabrikën e metalit në Kukës?

12 PË. Jo, nuk kam pa kurrë. Për -- q'aty te unë jo. Qaty kanë
13 hi nga 50 veta, 60 veta në ditë, aty s'ka pasë mundësi ajo
14 aty.

15 PY. Vuna re që thatë që nuk ke pa, nuk ke pa askënd që të
16 ketë qenë i ndalumë atje ku ke qenë ti. Por, kam një pyetje
17 tjetër në lidhje me këtë temë. A ke pa ndokënd tjetër që është
18 ndalu diku tjetër, në atë ambient ku ishte fabrika e metalit
19 në Kukës, në ndërtesat e tjera?

20 PË. Jo, Prokurore, s'kam pa.

21 PY. Z. Dëshmitar, a keni dijeni që Gjykata e Qarkut të
22 Mitrovicës ka pranë gjithashtu se disa prej këtyne të
23 ndaluarve janë detyru me punu me orë të gjata çdo ditë në
24 magazina duke shkarku mallrat që kishin ardhë për UÇK-në?

25 PË. Nuk është e vërtetë. Q'aty te unë, jo.

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 77

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

2 Avokat, ju shoh që jeni në këmbë.

3 Z. AOUINI: [Përkthim] Kjo është hera e dytë që po [E
4 padëgjueshme]. Ky dëshmitar, nuk është ekspert ligjor që të
5 dijë për fakte ligjore. Ky është dëshmitar për faktet dhe po
6 jep përgjigje për faktet. Disa nga pyetjet po bëhen disa herë,
7 po përsëriten disa herë.

8 Si mund ta pyesësh për shkarkimin e këtyre, si del kjo
9 nga aktgjykimi?

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
11 është legjitime që të bëhet pyetja, ka pasë aktgjykime në
12 lidhje me këtë çështje dhe ai mund të përgjigjet në lidhje me
13 to, ashtu siç bëri deri tani.

14 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
15 Gjykatëse. Unë vetëm e pyeta nëse kishte dijëni për këto
16 vendime të gjykatave, thjesht.

17 PY. Z. Dëshmitar, tani dua t'ju bëj disa pyetje për disa
18 individë të caktuar. A e njihni një person me emrin Sabit
19 Geci?

20 PË. E kam pa në televizor.

21 PY. A e ke pa ndonjëherë diku tjetër përveçse në televizor?

22 PË. Jo.

23 PY. A e ke pa ndonjëherë në fabrikën e metalit në Kukës?

24 PË. Jo, s'e kam pa.

25 PY. A e njihni një person me emrin Xhemshit Krasniqi?

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 78

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 PË. Po.

2 PY. Si e njef, prej kah e njeh?

3 PË. E njoh se e kam atje, katunar. Jemi të një vendi aty edhe
4 e njof.

5 PY. A e ke pa ndonjëherë z. Krasniqi në fabrikën e metalit në
6 Kukës?

7 PË. S'më kujtohet.

8 PY. A e dini nëse z. Krasniqi, a ka qenë ai anëtar i Brigadës
9 128?

10 PË. Jo.

11 PY. Domethënë, nuk e din, apo nuk ka qenë anëtar?

12 PË. Nuk ka qenë, se listën e di të veteranëve, për q'atë po
13 të them që nuk ka qenë [E padëgjueshme].

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

15 Avokat, çfarë deshët me thanë? Desha ta lija të përfundonte
16 dëshmitari.

17 Z. AOUBINI: [Përkthim] Por tani e kemi përgjigjen, dhe ne
18 nuk e dimë cila është baza që ke lidhur Krasniqin me këtë
19 brigadën. Ndoshta ne e dimë që ai vinte nga një brigadë
20 tjetër. Kjo përgjigje është dhënë më përpara.

21 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ky është një problem i madh. Ata
22 po japin informacion, një informacion të gabuar, dëshmitarit.

23 Për z. Krasniqi ne nuk kemi asnjë dokument, asnjë informacion
24 që ka qenë anëtar i Brigadës 128. Pse t'ia paraqesësh këtë

25 dëshmitarit? A është kurth?

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 79

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

2 Prokurore?

3 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Unë po bëja pyetje nëse ai e

4 dinte, nëse z. Krasniqi ishte anëtar apo jo. Unë nuk i thashë

5 është anëtar, e pyeta thjesht a kishte dijeni për anëtarësinë

6 e tij. Kjo ishte një pyetje e hapur, dhe desha që ta

7 eksploroja më tej, por ai tha që nuk ishte, kështu që kaq. Aty

8 mbeti.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë e

10 kuptova kështu dhe jam dakord me ju që nuk duhet të lejohet

11 askush që t'i japë informacion të gabuar ose të pasaktë

12 dëshmitarit.

13 Z. AOUINI: [Përkthim] Tani që e mora informacionin dhe

14 përgjigjen, e kuptoj. Faleminderit.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

16 Prokurore?

17 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

18 PY. A e njihni një person me emrin Mark Shala?

19 PË. Jo.

20 PY. A e njihni një person me emrin Bedri Azemi?

21 PË. Jo.

22 PY. A e njihni një person me emrin Fadil Zejnullahu?

23 PË. Fadil Zejnullahu, po e kam pa në Prishtinë një herë. Në

24 komision ka qenë aty, që aty e njoh, prej atyjshtit.

25 PY. A e ke pa ndonjëherë në fabrikën e metalit në Kukës?

1 PË. Jo, s'e kam pa aty. E kam takue në Prishtinë edhe qe po
2 më kujtohet që e kam pa aty Fadil Zejnullahun. Aty nuk e kam
3 pa. Ndoshta e kam pa atje, por s'e kam njoftë.

4 PY. Z. Dëshmitar, a e njeh një person me emrin Bedri
5 Dervishaj?

6 PË. Po.

7 PY. Si e njeh, prej kah e njeh?

8 PË. Jemi shokë me Bedrinë, dhe në miqësi me Bedrinë prej
9 motit.

10 PY. Kur ka qenë hera e fundit që e ke pa z. Dervishaj?

11 PË. Kur e kam taku para katër-pesë ditëve në Prizren.

12 PY. A e ke pa ndonjëherë në fabrikën e metalit në Kukës kur
13 ishe atje?

14 PË. Jo, s'e kam pa. Nuk kam dalë unë fort aty, unë kam ndjetë
15 vetëm në magazinë, nuk kam dalë kështu nëpër repart me këqyrë
16 se s'më ka interesu ajo punë mu, mu më ka interesu vetëm puna
17 jeme me kry punën teme. Kështu që s'më ka interesu aty gjonat
18 e tjera. Mu më ka interesu vetëm me dhanë uniformat, edhe
19 tjetër send s'më ka interesu mu se ça kanë pa ose çka -- nuk e
20 di atë [E padëgjueshme].

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
22 Prokurore, ju lutem prisni pak.

23 Z. AOUINI: [Përkthim] Më vjen keq që po ndërpres. Për të
24 korigjuar transkriptin me emrin. Këtu u pyet për -- u tha për
25 Bedri Azemin, por u tha Ademi. Është shkruar gabim në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 81

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 transkript.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
3 edhe unë ashtu e dëgjova -- Ademi.

4 Duhet të korrigjohet, është në rreshtin 23, faqja 72.

5 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Është me "Z", Bedri Azemi.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Faleminderit për këtë sqarim. Shikoj gjithashtu edhe që
8 transkripti do të rishikohet më vonë, është shënuar aty,
9 kështu që -- në rregull.

10 Mund të vazhdoni znj. Prokurore.

11 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

12 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

13 PY. Z. Dëshmitar, e ke parë ndonjëherë Pjetër Shalën në
14 fabrikën e metalit në Kukës?

15 PË. Jo.

16 PY. A e ke pa në ndonjë vend tjetër, gjatë asaj periudhe,
17 gjatë periudhës së luftës?

18 PË. Jo, nuk e kam pa kurrkund Pjetër Shalën. As nuk e njoh. E
19 njoh prej televizorit.

20 PY. Kur e ke pa në televizor?

21 PË. Qe tash, kur ka fillu gjykimi.

22 PY. Z. Dëshmitar, sot na ke thënë që nuk ke dijeni që ka pasë
23 njerëz të ndalumë në fabrikën e metalit në Kukës, në periudhën
24 kur ke qenë ti aty.

25 PË. Po, shumë e vërtetë, q'ashtu është.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 82

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të
2 kemi në ekran fotografinë që e kemi pa edhe më herët sot, për
3 një pyetje të fundit në lidhje me këtë temë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
5 nuk do të përsërisni gjërat me këtë.

6 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Jo, vetëm thjesht dua të sqaroj
7 diçka në lidhje me pozicionin e ndërtesës.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
9 rregull, sepse këtë temë e kemi trajtuar një herë.

10 Sekretare, ju lutem, a mund ta vendosni fotografinë sapo
11 të na jepet numri ERN i saj?

12 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Po, P00093 ose me ERN 074390.

13 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

14 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Më falni, s'kisha mikrofon.

15 PY. Dëshmitar, ju na thatë që as këtë ndërtesë nuk e keni pa
16 kurrë, kështu?

17 PË. Po, tregova pak më herët, Prokurore, s'e kam pa.

18 PY. Dëshmitar, ne kemi prova që kjo ndërtesë ka qenë në mes
19 të oborrit në fabrikën e metalit në Kukës. Ju po na thoni, po
20 na jepni dëshmi këtu, që nuk e keni pa kurrë këtë ndërtesë kur
21 keni kalu për me shku në magazinën ku punonit çdo ditë?

22 PË. S'po më kujtohet kjo, Prokurore. Ndoshta ka qenë, por
23 s'po më kujtohet mu. Kam harru. Se s'kam këqyrë çka ka anash,
24 kam këqyrë vetëm drejt ku jam kanë në punën teme edhe s'kam
25 këqyrë çka ka andej e këndeje. S'më ka interesu mu puna tjetër,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 83

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 mu më ka interesu veç puna jeme me kry punën teme, edhe për
2 punë të tjera s'më ka interesu mu çfarë u bo.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
4 Dëshmitar, megjithëse e kuptojmë që duhet të jepni dëshmi
5 vetëm për gjanat që i mbani mend, kjo është shumë e
6 rëndësishme, dua t'ju kujtoj që duhet të thoni të vërtetën dhe
7 duhet t'ju them se po përpigemi me imagjinu atë që po na
8 tregon ti. Dhe, domethënë, a ta kujtoj unë që ti ke ecë drejt,
9 pa pa as majtas as djathtas, edhe pa pa se çka ka pas aty
10 rreth e qark?

11 DËSHMITARI: Ndoshta ka qenë, ti Gjyqtare, por nuk më
12 kujtohet, se unë kam shku drejt e në magazinë. Ndoshta ka
13 qenë, mu s'po më bjen në mend hiç. Kjo punë, as idenë nuk e
14 kam për qetë që ma kanë qitë qetu. S'po më kujtohet, ndoshta
15 ka qenë. Po mu s'po më kujtohet.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Përgjigje shumë e qartë, faleminderit.

18 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
19 Gjykatëse. Tani do të kaloj në një temë tjetër dhe besoj që
20 kam vetëm pak pyetje të tjera për të bërë, dhe besoj që për
21 dhjetë minuta do të kryej punë.

22 A mund të hiqet fotografia?

23 PY. Dëshmitar, na the që ke qenë deri në qershor në fabrikën
24 e metalit në Kukës dhe gjithashtu na the që mbas kësaj je kthy
25 në Kosovë, dhe kjo është në faqen 28, rreshtat 5 deri në 9 të

1 transkriptit.

2 Ku ke shku në Kosovë, a mund të na e shpjegosh?

3 PË. Te shtëpia jeme.

4 PY. Ku ishte shtëpia në atë kohë?

5 PË. Në hymje të Prizrenit. Q'aty ku e kam q'tash.

6 PY. A ke shku ndonjëherë në Nashec?

7 PË. Jo, s'kam pasë lidhje me Nashec.

8 PY. Z. Dëshmitar, një ushtar tjetër në Brigadën 128 ka thënë
9 se Brigada 128, mbas lufte, ka shku në Nashec dhe ai të ka pa
10 aty.

11 PË. Unë nuk kam shku në Nashec. Brigada kur u tërhjekë prej
12 Nasheci, që kena shku në Tropojë, në Zym të Dragashit, unë
13 atëherë kam shku. Se një kohë nuk kam shku aty. Domethënë kur
14 është tërhjekë që është tërhekë me shkue që u mbajt prej UÇK-
15 së në Trupat Mbrojtëse të Kosovës, unë kam shkue në Dragash,
16 edhe kam shërby në Dragash dy vite në Trupat Mbrojtëse të
17 Kosovës.

18 PY. Atëherë, të shofim a e kam kuptu drejt. Kur brigada është
19 tërheqë, ti ke shku në Nashec. A është e saktë kjo?

20 PË. Prej -- po, prej Nashecit nuk kam ndejtur unë në Nashec.
21 Unë kam shku drejt nalt me logjistikë, kam shku drejt nalt në
22 Zym të Dragashit kur jena shpërngulë prej Nashecit. Se në [E
23 pakuptueshme] nuk kam dashtë me u kthy, domethënë, Trupat
24 Mbrojtëse të Kosovës, mandej jam kthy, kështu që kam vazhdue
25 në Zym të Dragashit, për dy vite.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 85

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 PY. Pra, shkuat në Nashec, edhe the që nuk ke qendru aty --

2 PË. Jo.

3 PY. -- a mund të na e shpjegosh pse ke shku?

4 PË. Kam shku, aty kam pas logjistikën. Domethënë, faktikisht
5 e kam çu bukën. Edhe domethënë shumë vonë, nuk e besoj, dhjetë
6 ditë para se me u ngritë prej Nashecit, ja kam çue bukën, që e
7 kam marrë prej Prizrenit, edhe jam kthye prapë.

8 PY. Sa kohë ka marrë kjo që ke çu bukën? Mund të na japësh
9 njëfarë kohe?

10 PË. Nuk po më kujtohet, ndoshta se shumë shpejt jemi ngritë,
11 shumë shpejt jemi dalë prej Nashecit. Kur jam shku une, shumë
12 shpejt jemi shku në Zym. Jemi tërheqë prej Nashecit, jemi shku
13 në Zym, dhe aty kam shërby në Zym, dy vite kam qenë
14 rregullisht. Në Zym, Dragash, kam punu atje në TMK.

15 PY. A ke qenë --

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
17 lutem, ndaloni pak. Avokati është ngritur në këmbë.

18 Z. AOUBINI: [Përkthim] Është -- përmendi një ushtar i
19 Brigadës 128, dhe deshëm ta dimë se kush është ky ushtar, që
20 të kontrolloj. Sepse nga dokumentet mund ose mund të mos jetë
21 e saktë, kështu që të na jepet informacioni përpara se sa të
22 bëjmë kundërshtime.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
24 mund të më thoni në cilin rresht është në transkript?

25 Z. AOUBINI: [Përkthim] Patjetër. Në faqen 76, rreshtat 24,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744

Faqe 86

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 25.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Pyetja e Prokurores është që:

4 "Një ushtar tjetër i Brigadës 128 ka thënë që Brigada 128
5 mbas luftës ka shku në Nashec dhe ai ju ka pa atje."

6 Pyetja është, cili ushtar -- për cilin ushtar e keni
7 fjalën, dhe cila është baza e pyetjes tuaj?

8 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Unë mund ta jap, por a mund të
9 hyjmë në seancë private, për këtë diskutim shkurtimisht?

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
11 mund të hyjmë në seancë private, Sekretare?

12 ~~{Seancë private}~~[Seancë e hapur] Riklasifikuar në bazë të F744

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Faleminderit.

16 Prokurore, kemi këtu dëshmitarin, a mund të bëhet kjo
17 pyetje në praninë e tij?

18 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse, ai
19 person nuk është dëshmitar i mbrojtur, person i mbrojtur, por
20 për arsye privatësie thashë ta jap referencën në seancë
21 private.

22 Kjo është deklarata e Idajet Gashit, dhe është deklarata
23 me numër 12 në listën e materialeve tona. ERN-ja është 065236-
24 TR-ET, Pjesa 2, dhe faqja përkatëse është faqja 11.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po me

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744

Page 87

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 sa kuptoj unë, pse kanë -- duhen kushtet, domethënë, seancë
2 private për këtë, pse nuk mund të jepet në publik?

3 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Thjesht meqë përmendet emri i
4 një personi që ka dhënë këtë informacion.

5 Por mund të kalojmë tani në seancë publike.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
7 Avokat, po?

8 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.
9 Ky nuk është dëshmitar në çështjen tonë, nuk është dëshmitar
10 që është i mbrojtur, dhe ne kundërshtojmë pse nuk jepet emri
11 dhe pastaj të kërkohet informacioni. Sepse kur nuk jepet emri
12 ne nuk kemi asnjë mundësi që ta -- kontrollojmë atë -- kush
13 është ky dëshmitar, Idajet. Pra, mënyra se si u bë pyetja nuk
14 e dimë me siguri në qoftë se ka qenë apo s'ka qenë në brigadë.
15 Ndoshta ata duhet të kishin dhënë disa baza se kush është ky
16 person, nëse e njeh këtë person, dhe këto duhet të ishin të
17 bëra të qarta dëshmitarit.

18 Por në këtë rast, nuk e shof të jetë bërë nga Prokuroria.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
20 z. Avokat. Unë këtë po përpiqesha të bëja.

21 Në rregull. As unë s'e kam të qartë pse të jemi në seancë
22 private, ai nuk është dëshmitar i mbrojtur. Unë këmbëngul që
23 të jemi sa më shumë në seanca publike. Dhe arsyeja e
24 privatësisë nuk mjafton. Ai në fund të fundit ka dhënë dëshmi.
25 Është e rëndësishme ta eksplorojmë pak më tej këtë, sepse ju

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744 Faqe 88

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 po thoni -- pra mënyra si e bëtë ju pyetjen nuk e bën të qartë
2 a ka qenë dëshmitari dhe kur ka qenë atje.

3 Kështu që unë propozoj të kalojmë dhe një herë në seancë
4 publike, dhe ta sqarojmë këtë aspekt. Dhe them që ta bëjmë në
5 seancë publike.

6 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Patjetër, kalojmë në seancë
7 publike.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
9 lutem, të kalojmë në seancë publike.

10 ~~{Seancë e hapur}~~

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Faleminderit.

14 Vazhdoni, znj. Prokurore, ju rikujtoj që të diskutojmë
15 dhe një herë atë që folëm në seancë private në seancë publike.

16 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

17 PY. Z. Dëshmitar, a e njihni një person me emrin Idajet
18 Gashi?

19 PË. Po, e njoh mirë.

20 PY. Si e njihni?

21 PË. Po, qe e shoh nëpër qytet, tanë ditën silleet.

22 PY. Në kohën e luftës, e njihnit?

23 PË. Jo. Nuk e di ku ka qenë. Ka thënë që ka qenë në Brigadën
24 128, por nuk e di.

25 PY. Pra ju po thoni që e keni takuar pas luftës, këtë po

1 thoni?

2 PË. Pas luftës.

3 PY. Z. Dëshmitar, z. Gashi ka deklaruar se ju keni qenë në
4 Nashec gjatë kohës që ka qenë edhe ai atje, pas luftës.

5 PË. Nuk e kam pa. Nuk më kujtohet. Ndoshta ka qenë, por unë
6 nuk e kam pa. Se unë në Nashec nuk kam nejtë, Prokurore.

7 PY. Por thatë që keni qenë të paktën një herë në Nashec për
8 të çuar bukë, kështu?

9 PË. Po, jo të paktën një herë, por kam shkue sa kam qenë aty
10 kohët e fundit, dhjetë ditë, i kam çu për çdo ditë. Jo një
11 herë, por për çdo ditë kam shku. E kam çu edhe mëngjesin,
12 drekën edhe jam kthyer për Prizren. Unë nuk kam ndejtë aty. Edhe
13 për qetë nuk e kam pa, nuk e di a ka qenë aty në Nashec apo
14 nuk ka qenë, Idajet Gashi. Nuk po më kujtohet mu. Se me e pa,
15 them, po, e kam pa, dhe në rregull.

16 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Në kohën kur mbërriti -- në
17 mbërritje, kur erdhi KFOR-i, dhe bastisi apo hyri në godinat
18 dhe çliroi të ndaluarit që ishin atje, ju ishit në Nashec,
19 kur mësyti në godina për të liruar të ndaluarit?

20 PË. Jo, nuk kam qenë.

21 PY. Po ju jeni në dijeni që KFOR-i erdhi në Nashec dhe liroi
22 disa persona që ishin të ndaluar atje?

23 PË. Kam ndi, mandej kur kam shku me çu dreka thanë ka qenë
24 KFOR-i, është kanë KFOR-i këtu, me fjalë. Nuk e di se çka ka
25 ndodhë. S'më ka interesu ajo pjesë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 90

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 PY. Por a e dini që KFOR-i çliroi, liroi, të burgosur nga
2 baza e Nashevcit ku ishte e vendosur UÇK-ja? E kuptoj që nuk
3 keni qenë i vendosur atje, por ama gjithashtu e kuptoj që keni
4 qenë -- një pjesë e brigadës së UÇK-së ka qenë atje.

5 PË. Unë nuk e di që ka pasë të ndalumë në Nashec. Nuk kam
6 informata. Nuk e di.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
8 Prokurore, po ja jap fjalën Avokatit.

9 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit. Dy pika. Fillimisht
10 donim të dinim qëllimin e këtyre pyetjeve, sepse nuk burojnë
11 nga pyetjet tona. Dhe lidhja me aktakuzën nuk është e qartë.
12 Nëse është çështje besueshmërie, ne nuk po e shohim, nuk po
13 vërtetohet. Dëshmitari e ka shpjeguar, ka shpjeguar çfarë roli
14 ka pasur. E kuptojmë interesin e përgjithshëm, por, të nderuar
15 Gjykatës, le të jemi të kujdesshëm. Ne nuk po hetojmë këtu,
16 dhe nuk e kemi thirrur për këtë qëllim dëshmitarin.

17 Nëse po përpiqen të shohin aspekte të besueshmërisë, me
18 kënaqësi do ta dëgjojmë. Nëse burojnë nga pyetjet që bëjmë ne,
19 po ashtu do t'i dëgjojmë me interes. Por asgjë më shumë se
20 kaq.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Faleminderit.

23 Prokurore.

24 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Qëllimi i këtyre pyetjeve është
25 për të vërtetuar besueshmërinë e dëshmitarit. Ne e kemi

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 91

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 dëgjuar dëshmitarin kur dha dëshmi se nuk ka pasur dijeni për
2 persona të ndaluar në fabrikën e metalit, jemi në dijeni të
3 faktit që ka pasur të ndaluar dhe në vendet e tjera ku thotë
4 që ka qenë dhe dëshmitari për periudha kohore, dhe duam të
5 kuptojmë a ka dijeni për këto ndalimet e tjera. Pra qëllimi
6 është tamam të vërtetojmë besueshmërinë e tij sepse ne
7 mendojmë që çdo informacion apo dhe mohim lidhur me këto
8 ngjarje është i rëndësishëm për besueshmërinë e këtij
9 dëshmitari.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Faleminderit. Do ta lejoj këtë linjë pyetjesh. Unë dhe prandaj
12 e kisha lejuar që të vijonte. Vazhdojmë.

13 Znj. Prokurore, fjala është për ju.

14 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] NË fakt, mbarova me këtë linjë
15 pyetjesh, dhe do të kaloj te pyetjet e fundit.

16 PY. Z. Dëshmitar, kam edhe disa pyetje për ju. A i treguat
17 ndokujt që po vinit për të dhënë dëshmi përpara Dhomave të
18 Specializuara?

19 PË. Po.

20 PY. Kujt?

21 PË. Nji shokut tem që kam qenë me të.

22 PY. Si e ka emrin shoku?

23 PË. Bashkim Hoxha.

24 PY. Vetëm këtij personi i tregove që po vije për të dhënë
25 dëshmi?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 92

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 PË. Po vetëm me këtë rri unë, vetëm me këtë Bashkimin.

2 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua t'i
3 tregoj dëshmitarit disa postime në Facebook, që i kemi
4 përfshirë në listën tonë të prezantimeve, dhe mund t'i jap
5 edhe referencat nëse i lejoni.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

7 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Është materiali numër 15 në
8 listën tonë, do jap edhe numrin ERN. SPOE00341607 deri në
9 SPOE00341607-ET.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Vazhdoni.

12 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Mbase do e ndihmonte më shumë
13 dëshmitarin të shihte shqipen, versionin në shqip të këtij
14 materiali, që ka numrin SPOE00341607 deri në 1614. Faqen e
15 parë nëse është e mundur.

16 PY. Z. Dëshmitar, a e shihni këtë postim në Facebook?

17 PË. Po, po e shoh, Prokurore.

18 PY. Nëse e kuptoj unë siç duhet, këtë e ka postuar Lagjja
19 Bajram Curri, Prizren.

20 PË. Po, Lagjja Bajram Curri, është një kojshi aty edhe normal
21 unë s'mund t'ia ndali Facebook-un kurrkujt. Ky nuk është
22 Facebook i jem. Unë s'muj me i thanë, mos i qit, mos i qit.
23 Unë nuk muj me thanë pra, nuk muj me iu përgjigj kurrkujt unë
24 për Facebook. Unë nuk kam postu asnjigja. Unë s'kam postu
25 asnjigja në emën tim. Nuk kam postu.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 93

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 PY. E kuptoj. Por na the që vetëm një shoku i ke treguar që
2 po vije për të dhënë dëshmi --

3 PË. Po...

4 PY. -- tek Dhomat e Specializuara, apo jo?

5 PË. A muj me folë? Këqyre mirë shënimin, domethënë,
6 faktikisht shënimet janë bërë prej të Facebook-ut të Bashkim
7 Hoxhës janë ba te Lagjja Bajram Curr. I njëjti postim është.
8 Edhe unë s'mund me i ndalë kurrkujt postimet ça bajnë.

9 PY. Absolutisht. Unë më shumë desha të kuptoja nga e mësoi ky
10 komshi që do vije të jepje dëshmi?

11 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Shohim një postim tjetër
12 Facebook-u, që është numri 17 i listës sonë. Që mban numër 17.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Vazhdoni.

15 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] ERN SPOE00341648 deri në
16 SPOE00341651. Kjo është shqipja. Mund t'ju jap edhe referencën
17 për anglishten.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Vazhdoni dhe me anglishten.

20 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Që është 1648-ET.

21 PY. Z. Dëshmitar, po këtë postim -- ?

22 PË. Ky e ka marrë postimin prej të njëjtit Facebook, prej
23 Bashkim Hoxhës, e njof fort mirë këtë shokin. Ky ka qenë në
24 luftë. Është Uran Badalli prej fshatit Zhur. Është i plagosun.
25 Edhe unë nuk mundem me e ndalë as këtë mos me postu.

1 Merre ti Facebook-un e parë, Prokurore, prej Facebook-ut
2 të parë i kanë marrë të gjithë i kanë shpërnda ma tej qeta.
3 Nuk e di a e din Facebook-un që ka postu Bashkimi, se vetëm ai
4 e ka ditë, ai e ka postue. Unë nuk kam postu asgjë, edhe nuk
5 kam në emën tem asnjigja të postume. Edhe nuk muj me i ndalë
6 njerëzit ça postojnë edhe ça shkrujnë. Nuk mujna me i thanë.
7 PY. Dëshmitar, ju po thoni se burimi i informacionit është i
8 njëjti person, Bashkim Hoxha, kështu?

9 PË. I njëjti person. Ai e ka postue domethënë faktikisht
10 edhe, domethënë, këto që e kanë marrë, si Lagjja Bajram Curri
11 që e ka qitë, sikur ky Uran Badalli, edhe faktikisht e ka
12 marrë -- postimin e kanë marrë prej Bashkim Hoxhës. Unë nuk
13 kam postu kurrëgjë, Prokurore. Edhe nuk postoj kurrë, nuk
14 postoj. E keni Facebook-un tem veç këqyre që s'postoj unë kesi
15 gjana.

16 PY. Faleminderit.

17 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] A mund të zmadhojmë pak
18 postimin, sepse dua që t'i kërkoj dëshmitarit të shohë
19 rreshtin e parë dhe të dytë. Dhe unë po lexoj përkthimin në
20 anglisht, por dëshmitari mund ta ndjekë me shqipen.

21 PY. Lexohet kështu:

22 "Bashkëluftëtari im Naser Koçinaj është ftuar si
23 dëshmitar në Hagë. A e di se do kthehesh faqebardhë, o trim".

24 Z. Dëshmitar, për çfarë e ka fjalën ky person kur thotë
25 "Ti do kthehesh faqebardhë"?

1 PË. Nuk mund me ja ditë njerëzve mendjen qysh, çka të thujsh.
2 Nuk muj me ditë unë, për shembull, çka mendon ai, edhe ça
3 shkrun ai, s'po e di unë ça shkrun. Edhe unë tash mund me i
4 shkrujt këtijna çka don, unë -- qysh këto [E pakuptueshme] unë
5 s'muj me i ndalë unë njerëzit çka shkrujnë. Ai mun me shkrujt
6 çka të dush. Mundet edhe me më shajhtë këtu në Facebook. Mundet
7 dhe me shkrujtë mirë, mundet dhe me shkrujtë keq. Unë s'po
8 mundem me i thanë asigja. As nuk i them me e heqë. Se nëse i
9 them me e heqë, unë domethënë faktikisht dal keq aty. Ai e din
10 vet se kush e din atë. Unë kam shoqni, kam rrathë, kam shoqni
11 edhe --

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Dakord. Dhatë një përgjigje të qartë. Znj. Prokurore dhe ju
14 besoj se e keni shtjelluar mjaftueshëm.

15 Shoh që jeni çuar në këmbë, po besoj se dëshmitari e bëri
16 shumë të qartë atë që kishte për të thënë në lidhje me këtë.

17 Z. AOUINI: [Përkthim] Mirë, po e lë pikën e dytë, meqë u
18 shterua. Por të jemi të drejtë për procesin gjyqësor, duhet
19 t'i kishim treguar fillimisht postimin fillestar sepse
20 dëshmitari tha që është marrë prej postimit fillestar,
21 origjinal, edhe të shohim datën e postimit origjinal edhe
22 ripostimin që është bërë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
24 mund të na jepni numrin e postimit të parë atëherë? Se do të
25 doja ta shihja për ta kuptuar më qartë pikën që po ngrini ju.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 96

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 Z. AOUINI: [Përkthim] Nëse e kam gabim, kolegët të më
2 korrigjojnë. Postimi origjinal është i datës 25 shtator, dhe
3 është i Bashkim Hoxhës, ka numër 21 në listën e materialeve të
4 Prokurorisë. Më saktë po jap ERN-në, SPOE00341652-
5 SPOE00341652-ET, me sa kuptojmë ne ky është postimi origjinal,
6 i cili është ripostuar më pas përmes postimeve që ne pamë.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Atëherë do të bëj një pyetje. Nuk ju është treguar ky postim?
9 Nuk është treguar ky postim? Nëse thoni jo, po e lëmë me kaq.
10 Dhe sipas jush ju thoni që duhet ta kishim treguar postimin
11 origjinal.

12 Z. AOUINI: [Përkthim] Ne me sa kuptojmë, ky ka qenë
13 postimi origjinal, dhe më pas është ripostuar dhe ripostimi i
14 është treguar dëshmitarit. Pra, është ripostuar të nesërmen,
15 dhe ky iu tregua dëshmitarit. Është ajo që kolegu im i nderuar
16 i tregoi dëshmitarit dhe materiali SPOE00341607.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po ja
18 jap fjalën znj. Prokurore, nëse ka gjë për të thënë. Por, ajo
19 që po thoni ju, materiali që po thoni ju, që duhet të ishte
20 treguar i pari, pra postimi i 25 shtatorit, më duket se unë e
21 pashë në ekran. Por mbase, mbase e kam gabim dhe unë.

22 Po ia jap fjalën Prokurores.

23 Z. AOUINI: [Përkthim] Ju kërkoh ndjesë. Këtë doja të
24 thoja. Është një -- është ripostuar e njëjta përmbajtje,
25 prandaj ju duket sikur e keni parë më herët.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 97

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo
2 ky. Në rregull, sidoqoftë.

3 Znj. Prokurore.

4 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Pyetja ime lidhej me përmbajtjen
5 e postimit. Unë nuk po trajtoja burimin, postimi i parë të
6 cilit i referohet avokati, më duket se ka numrin 16 në listën
7 tonë, edhe mbaron me numrin 1652. Po mund ta pyes dëshmitarin
8 dhe për këtë sepse e kemi postimin.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Këtë
10 pikë deshët të parashtonit dhe ju? Se më duket sikur nuk
11 ishte kjo e njëjta gjë.

12 Z. AOUINI: [Përkthim] Qëllimi jonë ishin -- është e
13 drejtë të fillojmë me postimin që sipas dëshmitarit është
14 postimi origjinal. Që të mos krijohet përshtypja në këtë
15 proces gjyqësor që ky postimi i dytë ka qenë postimi
16 origjinal, pra postimi që ka bërë zotnia i dytë. Nuk ka qenë
17 postimi origjinal, sepse ka qenë thjesht një ripostim i një
18 postimi të mëhershëm që ka bërë Bashkim Hoxha. Përmbajtja e
19 njëjta është, por të marrim radhitjen për çështje drejtësie,
20 për të qenë të drejtë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Fjala
22 është për ju.

23 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Mendoj që dëshmitari e shpjegoi
24 vetë shumë mirë dhe tha, ishte ripostim. Dhe unë nuk e -- nuk
25 bëra më pyetje shtesë. I tregova dhe një postim tjetër, sepse

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 98

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 dukej sikur buronte nga një person tjetër dhe jo nga komshiu.
2 Pra jo nga burimi origjinal. E pyeta për këtë, dëshmitari e
3 sqaroi që sipas tij çdo gjë ka buruar nga personi me të cilin
4 ka folur.

5 Unë tani po trajtoja diçka me përmbajtjen e postimit, por
6 me kënaqësi mund të flasim për postimin origjinal në rend
7 kronologjik, dhe të bëjmë të njëjtat pyetje.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Faleminderit.

10 Sa i takon punës së drejtësisë së procesit, besoj se
11 është bërë e qartë, të paktën dëshmitari na e ka bërë të qartë
12 që ishte ripostim. Nuk mendoj se pati ndonjë keqkuptim për
13 Trupin Gjygues. Dëshmia, sipas dëshmitarit nuk ka asnjë
14 shtrembërim të asaj që ka ndodhur në të vërtetë. Kështu që
15 mund të vazhdojmë. Dhe nuk mendoj se duhen bërë pyetje të
16 mëtejshme në lidhje me këtë.

17 A ka ndonjë gjë tjetër në lidhje me këtë drejtim? Se unë
18 po shikoj orën. Ora është -- do dhe 35 minuta që të
19 përfundojmë për sot, po përpiqem të kuptoj dhe sa kohë ju
20 nevojitet ende dhe nëse duhet të bëjmë pushim, apo të
21 vazhdojmë deri në 16.00.

22 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Ja, më jepni një çast të flas me
23 kolegët.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
25 unë do të kontaktoj njëkohësisht me NJAGJ-në.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 99

Pyetje të palës tjetër nga z. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

2 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

4 Prokurore.

5 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Përfunduar me pyetjet tona me

6 këtë dëshmitar. Ju kërkohet ndjesë që nuk e mbajtëm parasysh

7 kohën, do përpigemi të jemi më të saktë herën tjetër, më të

8 kujdesshëm herën tjetër.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Faleminderit.

11 Z. Dëshmitar, Zyra e Prokurorit të Specializuar përfundoi

12 me pyetjet për ju. Tani po i drejtohem Mbrojtësit të Viktimave

13 për të parë nëse ka pyetje për ju.

14 Mbrojtësi i Viktimave.

15 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kemi pyetje.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 Faleminderit.

18 Po shoh Mbrojtjen. Avokat, keni pyetje shtesë?

19 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo, nuk kemi pyetje shtesë,

20 faleminderit.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Faleminderit.

23 Tani do të diskutoj pak me kolegët për t'u kuptuar si

24 është situata nga ana jonë dhe njëkohësisht presim dhe

25 përgjigjen e NJAGJ-së.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 100

Çështje procedurale

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Mikrofoni
3 çaktivizuar]

4 [Anëtarët e Trupit Gjykses dhe Sekretarja e
5 Gjykatës këshillohen]

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
7 Shala, fjala është për ju.

8 I AKUZUARI: [përmes videolidhjes] Znj. Gjyqtare, a ka
9 mundësi vetëm dy minuta me më dhanë pauzë, deri në tualet.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
11 bëjmë dhjetë minuta pushim. Tani do bëjmë dhjetë minuta --

12 I AKUZUARI: [përmes videolidhjes] Jo -- dy minuta, nuk ka
13 nevojë më shumë, veç dy minuta.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Sidoqoftë ne do bëjmë një pushim dhjetë minuta ne.

16 I AKUZUARI: [përmes videolidhjes] Okej.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Atëherë, bëjmë dhjetë minuta pushim.

19 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

20 --- Pauza fillon në orën 15.29

21 --- Seanca rifillon në orën 15.41

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
23 se erdhët përsëri të gjithë.

24 Vërej që kemi të njëjtën përbërje të ekipeve si para
25 pushimit që bëjmë për 10 minuta, po kështu edhe z. Shala është

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 101

Pyetje nga Trupi Gjykses

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 këtu me ne. Atëherë të thërrasim përsëri dëshmitarin për
2 pjesën e fundit të seancës së sotme.

3 Faleminderit -- Asistente që ta sillni dëshmitarin.

4 [Dëshmitari vijon dëshminë]

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Dëshmitar, mirë se erdhët përsëri për pjesën e fundit të kësaj
7 seance.

8 DËSHMITARI: Faleminderit, Gjyqtare.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
10 bënë disa pyetje nga ekipi i Mbrojtjes, pastaj nga
11 përfaqësuesja e Zyrës së Prokurorit të Specializuar, dhe tani
12 Gjykatësit do t'ju bëjnë disa pyetje. Do t'ia jap fjalën
13 Gjykatësit Bitti, që është në të majtën time. Ai ka disa
14 pyetje për ju.

15 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit, znj. Gjykatëse.

16 Pyetje nga Trupi Gjykses:

17 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Dëshmitar, sot në faqen 63 të
18 transkriptit, në rreshtin 5, dhe 6, the që:

19 "Doktori erdhi në magazinën ku punoja unë dhe mori
20 uniformën..."

21 A mund të na e përshkruash çfarë uniforme mori doktori?

22 PË. E ka pasë uniformën e ushtrisë, aty unë ia kam dhanë, të
23 UÇK-së. Prej atyshit ja kam dhanë unë.

24 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] A i ke dhënë edhe kapelë?

25 PË. Nuk po më kujtohet për kapelë, por uniformë e di që ia

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Naser Koçinaj (Seancë e hapur)

Faqe 102

Pyetje nga Trupi Gjykses

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 kam dhanë. Me siguri komplet, se aty kanë qenë uniforma
2 complete.

3 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Atëherë, ata që ishin
4 personel mjekësor i UÇK-së, ata mbanin uniforma, kështu?
5 PË. Po, ai e ka pasë.

6 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull. Meqë je
7 specialist, ekspert në uniformat e UÇK-së, a ke dijeni, a kanë
8 mbajtur bereta ose kapela të kaltra ushtarët e UÇK-së?
9 PË. S'po më kujtohet kjo, vetëm aty kanë marrë -- te unë nuk
10 ka pasë asi bereta, ka pasë vetëm domethënë, faktikisht, që
11 kanë qenë kështu të -- me -- nuk ka pasë asnjë beretë aty. Te
12 magazina, nuk ka pasë.

13 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull. Atëherë, asnjë
14 prej ushtarëve të cilëve ju ke dhënë uniforma, asnjë prej tyre
15 nuk kishte kështu bereta?

16 PË. Jo, qaty nuk ka pasë bereta.

17 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull, faleminderit. Kur
18 ke shku me punu në fabrikën e metalit në Kukës, a duhet të
19 identifikohesh, ti thoshe dikujt se kush ishe?

20 PË. Jo.

21 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Pra, ti mund të largohesh,
22 të dilsh prej fabrikën e metalit e të hyjshe aty sa herë të
23 dojshe?

24 PË. Unë po. Unë kam dalë, e kam pasë punën ashtu. Kam hi, kam
25 dalë, kur kam pasë punë kam shku edhe në shtëpi, për nevojat e

1 mia personale.

2 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Nuk ka pasë roje te dera që
3 kontrollonte njerëzit që kanë hyrë e kanë dalë? A je i sigurt
4 për këtë?

5 PË. Jo, ka pasë aty. Ka qenë përgjegjës -- një përgjegjës ka
6 qenë, ai Salih Saramati, përgjegjës te dera ka qenë ai.

7 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Ishte z. Saramati që rrinte
8 te dera?

9 PË. Salih Saramati.

10 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Po, faleminderit. Më duket se
11 na the që ti kishe çelësat e magazinës. I ke pasë ti tanë
12 kohën me vete?

13 PË. Unë e kam mshelë, domethënë, kam shkue në shtëpi
14 faktikisht. Kur kam shku në drekë, unë e kam lanë çelë
15 magazinën, magazina ka ndejtë çelë. Por kur kam shku në
16 mbrëmje në shtëpi e kam mshelë.

17 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Dhe ti ke qenë i vetmi person
18 që ke pasë çelësat e asaj magazine?

19 PË. Unë e kam pasë çelësin, po, ka pasë ndoshta edhe ai
20 tjetri, por unë nuk e di a ka pasë ai përgjegjësi jem. Me
21 siguri ka pasë edhe ai, por unë nuk e di. Unë e kam mshelë, e
22 kam çelë. Kur kam shku në drekë, për shembull, për me hangër
23 bukë, e kam lanë çelë, ka qenë -- se kanë qenë të tjerët aty.

24 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Pra, nuk ishte ti i vetmi që
25 mund të hyjshe aty në atë magazinë, edhe që e ke mshelë edhe e

1 ke çelë atë magazinë?

2 PË. Jo, ka qenë dhe Rexhepi.

3 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull. Pra jemi -- e
4 kemi të qartë tash, që edhe persona të tjerë mund ta
5 përdorshin atë magazinë kur ti nuk ishe aty?

6 PË. Ka muj vetëm Rexhepi, ka muj vetëm ai. Tjetërkush s'ka
7 mujt.

8 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull. Shumë
9 faleminderit. Nuk kam pyetje të tjera.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Faleminderit, Gjykatës Bitti.

12 Z. Dëshmitar, atëherë kemi mbërritë në fund të dëshmisë
13 tuaj, dhe desha t'ju falënderoj për përpjekjet që ke bë me
14 dhënien e dëshmisë tuaj që besoj se do ta ndihmojë Trupin
15 Gjykses. Prandaj dhe faleminderit shumë.

16 DËSHMITARI: Faleminderit dhe prej juve, Gjyqtare.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
18 kujtoj edhe njëherë që nuk duhet ta diskutoni me askënd
19 dëshminë që keni dhënë këtu para Trupit Gjykses.

20 DËSHMITARI: Okej.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
22 Asistentja do t'ju ndihmojë me dalë prej sallës së gjyqit.

23 DËSHMITARI: Faleminderit.

24 [Dëshmitari largohet]

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A ka

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 ndonjë diçka tjetër nga Prokuroria, a doni të ngrini ndonjë
2 çështje?

3 Mbrojtësi i Viktimave?

4 Z. LAWS: [Përkthim] Jo.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mbrojtja?

7 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Faleminderit.

10 Atëherë seanca mbyllet, dhe sa më shpejt që të jetë e
11 mundur do t'ju njoftojmë palët dhe Mbrojtësin e Viktimave se
12 kur do të vazhdojmë.

13 Për momentin, përpara se sa ta mbyll seancën, desha të
14 falënderoj stenografen për ndihmën e saj, si edhe ekipin
15 audiovizual, si dhe përkthyesit dhe ekipin e sigurisë.

16 Seanca mbyllet.

17 --- Seanca mbyllet në orën 15.51

18

19

20

21

22

23

24

25